



LIBRI MIKROMODEL KOMUNIKUES

DR. IBRAHIM BERISHA

Libri me një traditë 5 mijë vjet është shkrimi vetë, ndërsa shkrimi ka pasur nga filli rolin e transmetuesit edhe të informatës. Këtë rol e barti nga dalja në dritë e shenjave të para, siç konstatojnë komunikologët, të cilat do të kenë nisur 35-40 mijë vjet më parë nga homo sapiens në formën e vizatimeve monumentale në shpella. Gjuha e vizatimeve ishte universale, sepse mund të kuptohej edhe nga grupe që flisnin krejtësisht gjuhë tjetër. Është kjo gjuhë-sistem (pak-strukturë dhe shumë-praktikë) e të shprehurit, e paraqitjes dhe komunikimit pragmatik. Po, gjuha nëna e

arsyes, shprehet Haman, edhe sot, kryen njërin nga funksionet simbolike të mendjes dhe, po kështu, edhe atë të objektivizimit të ndjenjave, mu sikur para 40 mijë vjetëve. Këto vizatime brenda vetes manifestojnë rrëfimin komunikues, atë që tash e ndërtojnë mediat masive duke përdorur edhe teknologjitë digjitale. Por, a i përkitnin vizatimet e tilla piktografike dhe ideografike komunikimit masiv, megjithatë nuk është kjo një përgjigje e lehtë për t'u dhënë, pa u saktësuar funksioni real i shpellave-galeri. Sa dihet, ky lloj komunikimi ishte të folur shkrimor publik, paraprijës i fonogrameve. Në një mënyrë apo tjetër, kjo detyron njeriun të drejto-

het “kah vizuelizimi, koncentrimi dhe zhvillimi i formave simbolike e operationale”. Pikërisht pse njeriu shumë shpejt nis të përdorë këtë proces vizuelizues që e mundëson shkrimi fonetik, ai detyrohet të ndryshojë thuaja tërësisht mënyrën e jetës së tij. Rëndësia e këtij vizuelizimi qëndron në krijimin e një procesi shumë intensiv të integrimi me të mëdha mes njerëzve në njërin anë dhe, të forcimit të individualizimit njerëzor, në anën tjetër. Këtë proces teoriku i artit Rudolf Arnhajm e quan “mendimi i vizuelizuar”, përmes të cilit mundësohet krijimi i individualizimit dhe njëkohësisht edhe shkatërrimi i kulturës fisnore.

/vijon në faqen 8/

LIBRI I KONFERENCËS KOMBËTARE

KONFERENCA KOMBËTARE E BIBLIOTEKONOMISË "BIBLIOTEKA DHE KUJTESA KOMBËTARE"
(EDICIONI II) 20 - 22 NËNTOR 2007: MATERIALET E PUNIMEVE TË KONFERENCËS KOMBËTARE
TË BIBLIOTEKONOMISË, BKUK, PRISHTINË 2008

Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë, e themeluar në shtator të viti 2006, si institucion i ri kulturor-shkencor i përbashkët Shqipëri - Kosovë, realizoi edicionin e dytë me temën „Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare”, prej 20-22 nëntor 2007 në Prishtinë. Në konferencë morën pjesë autoritete të drejtimit dhe menaxhimit të bibliotekave kombëtare, universitare, publike etj.

BKUK botoi në një botim të veçantë të gjitha materialet e punimeve të Konferencës. Në këto punime trajtohen problematika që lidhen me kujdesin që duhet treguar në epokën digjitale ndaj kujtesës kombëtare, edhe sfidat me të cilat përballen sot sistemi i bibliotekave në Shqipëri dhe Kosovë.

Ky botim i veçantë përmban referime dhe kumtesa, që lidhen me temën bosht: mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe prezantimin e kujtesës kombëtare të popullit shqiptar nëpër shekuj, si të Prof. dr. Sali Bashotës me titull: „Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare”, për rolin dhe rëndësinë që luajtën relatorët shqiptarë në ruajtjen dhe ndriçimin e historisë së Kosovës gjatë shekullit XVII, referoi Gjon Berisha nga BKUK-ja. „Bibliotekat digjitale dhe kujtesa kombëtare, konflikt dhe/ose harmoni“, ishte tema me të cilën u prezantua znj. Etleva Domi nga BKSH-ja.

Në këtë botim, vend të veçantë zënë edhe punimet e disa sesioneve me temat bosht, si: “Trinomi bibliotekë - arkiv -



muze dhe kultura kombëtare“, nga Farfuri Xhaja dhe Alda Biçoku; „Arritje dhe mundësi të reja për ndriçimin e vlerave të rralla të kujtesës kombëtare“ nga Mejli Kokona; Hartat e shek. XVI-XIX, pjesë e kujtesës kombëtare”, nga Afërdita Sharrxhi; „Mosdokumentimi apo kërkimi i së humburës“ nga Fazli Gajraku; „Libri i dekadave të para të shtetit shqiptar: dukuri dhe probleme bibliotekonomike, sipas Bibliografisë retrospektive“ nga Maksim Gjinaj; „Trashëgimia kombëtare e shkruar dhe publiku“ nga Ramazan Vozga etj.

Në fund të këtij botimi të veçantë, paraqitet e plotë edhe Rezoluta e Konferencës në Prishtinë.

Gjon BERISHA

Në këtë numër



LIBRI MIKROMODEL KOMUNIKUES1

EQREM ÇABEJ NË TRI TEKSTE
BIBLIOGRAFIKE4

BIBLIOGRAFIA NË SHËRBIM TË PUNËS
KËRKIMORE-SHKENCORE6

QYSH U SHKATËRRUAN LIBRAT?10

KATALOGU DHE KATALOGIMI - PERSPEKTIVA
E ZHVILLIMIT TË PROGRAMIT ALEPH 500
NË KOSOVË12

INFORMACIONI I NJËSIVE BIBLIOGRAFIKE NË
FORMATIN MARC14

ALEPH-1 DHE PROCESI I PASURIMIT TË
KOLEKSIONEVE NË BKUK16

FATI I GAZETAVE E I GAZETARËVE18

BIBLIOTEKA
KOMBËTARE
DHE UNIVERSITARE
E KOSOVËS



THE NATIONAL
AND UNIVERSITY
LIBRARY
OF KOSOVO

www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Prof. dr. Sali Bashota

Kryeredaktor: Fazli Gajraku

Këshilli redaktues: Besim Kokollari, Bukuriye Haliti

Realizimi kompjuterik: Hekuran Rexhepi

Adresa: Sheshi “Hasan Prishtina”, p.n. Prishtinë

Tel: ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** biblioteka@biblioteka-ks.org

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË - NGJARJE E RËNDËSISHME PËR KULTURËN DHE BIBLIOTEKAT

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Ambasada Amerikane në Prishtinë, organizuan Edicionin e gjashtë - *Java e Bibliotekës në Kosovë*, nga data 14 deri më 19 prill 2008. Manifestimi, gjatë të cilit u zhvilluan aktivitete të rëndësishme kulturore: seminare, ligjërata, ekspozita, promovime, donacione, përrurime, u mbajt në Prishtinë, Prizren dhe Gjilan.

Në *Javën e Bibliotekës në Kosovë*, që është ngjarja me rëndësishme e vitit për kulturën dhe bibliotekat në Kosovë, mori pjesë Karen Coyle, konsultante për bibliotekat digjitale (Universiteti i Kalifornisë), si dhe njohës e hulumtues të tjerë të bibliotekarisë e të kulturës nga vendi dhe bota, të cilët diskutuan e shkëmbyen përvoja dhe ide që shpalosin vizionin e së ardhmes së bibliotekave nëpërmjet sistemit të automatizuar bibliotekar. Në këtë aktivitet, ishin të pranishëm, gjithashtu, edhe përfaqësues të institucione kulturore dhe arsimore të Kosovës ë të Shqipërisë, si dhe përfaqësues të ambasadave dhe zyrave diplomatike në Prishtinë. Në kuadër të veprimtarive të *Javës së Bibliotekës në Kosovë*, është promovuar projekti “Kujtesa e Kosovës”, ku janë ekspozuar tituj të zgjedhur, të cilët janë pjesë e fondit të këtij projekti. Është



Hapja solemne - Java e Bibliotekës në Kosovë 2008

promovuar, gjithashtu, vepra e punuar në dru “Libri i Pavarësisë” i autorit Behxhet Abdullahu.

Gjatë *Javës* është përruruar Biblioteka e Fakultetit të Filologjisë, e cila me infrastrukturën që tashmë ka, do të sjellë në varg shërbimesh të reja për përdoruesit e bibliotekës, si: shërbimin e referencave, shërbimin e koleksioneve lëndore, fonde të hapura etj. Me rastin e këtij përrurimi, është organizuar edhe debati “Universiteti i Prishtinës dhe bibliotekat”.

Në *Javën e Bibliotekës* është bërë edhe nënshkrimi i aktit të ri të Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotelës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, nga drejtorët Aurel Plasari e Sali Bashota. Marrëveshja parashikon

bashkëpunim në fushën e shkencës së komunikimit, bibliotekonomisë, shërbime botimesh bibliografike dhe profesionale, shërbime të veprave të botuara në Shqipëri dhe Kosovë, projekte, botime, veprimtari përkujtimore të përbashkëta etj.. Ky bashkëpunim filloi me veprimtarinë e përrurimit të veprës studimore të Eqrem Çabej “Hyrje në Indoeuropianistikë”, të shoqëruara me CD edhe zërin e regjistruar të Çabejt në leksionet që ai ka mbajtur gjatë vitit 1971-1973 në Universitetin e Prishtinës.

Të organizuara nga Biblioteka ndërkomunale “Fan S. Noli”, aktivitete të *Javës* janë mbajtur edhe në Gjilan. Këtu është ekspozita e librit amerikan në Kosovë dhe është organizuar debati “Bibliotekaria në Kosovë”. Ndërsa, në Prizren është organizuar Dyvjetori i Këndit Amerikan në Prizren, si dhe është zhvilluar debati “Bibliotekat digjitale - si të përdoren mënyra digjitale për ruajtjen dhe katalogimin e librave të rrallë dhe të vjetër”.

Gjatë kësaj *Jave*, është organizuar edhe *Dita e Dhurimit të Librit*. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dha mirënjohje për institucion dhe individë që kanë dhënë kontributin në pasurimin e koleksioneve të bibliotekës dhe zhvillimin e cilësisë së shërbimeve bibliotekare.



Nënshkrimi i Aktit të ri të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes BKUK-së dhe BKSh-së, në manifestimin Java e Bibliotekës në Kosovë

EQREM ÇABEJ NË TRI TEKSTE BIBLIOGRAFIKE

(Me rastin e 100-vjetorit të lindjes)



MR. TAHIR FONIQI

PARATEKSTI BIBLIOGRAFIK

Studimet tona, në Kosovë sidomos, vazhdojnë të bëhen me një mangësi të dorës së parë. Paralel, me to, nuk hartohen bibliografi përkatëse për fushat e caktuara studimore dhe ngjarje e personalitete të shquara krijuese. Kështu, kohë më parë, është shënuar 70-vjetori i lindjes së dy kolosëve të letrave shqipe Rexhep Qosja e Ismail Kadare, pa u hartuar bibliografia e veprës së tyre letrare e shkencore. A nuk ia vlen, po e zëmë, të hartohet një bibliografi vetëm për romanin “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” të Ismail Kadaresë: botimet, përkthimet në gjuhët e huaja botërore, rreth pesëdhjetë, shkrimet e shumta kritike për romanin etj.

Së pari duhet të hartohen bibliografite përkatëse e tevona të organizohen jubile e Konferenca shkencore për personalitete krijuese e ngjarje kulturore e shkencore.

Bibliografia është në shërbim të dijes, që krahasohet me rolin e enciklopedisë. Ajo është fryma e sharmi i punës krijuese, thënë figurativisht.

Të Eqrem Çabej e kemi një fakt kurajues.

Për Çabejn, brenda viteve 2000-2006, janë botuar tri tekste bibliografike me vlerë: Mina Gero, Petrit Kotrri, “Bibliografi e shkrimeve kushtuar Prof. Eqrem Çabejt (1934 - 1999)”, Prof. Dr. Jup Kastrati, “Bibliografia e Profesor Eqrem Çabejt 1929-1981”, Begzad Baliu, “Çabej 1: Bibliografi e studimeve të veprës së Çabejt në Kosovë 1952 - 2002”.

MINA GERO, PETRIT KOTRRI, BIBLIOGRAFI E SHKRIMEVE KUSHTUAR PROF. EQREM ÇABEJT (1934 - 1999)

Ky tekst përfshin 520 zëra bibliografikë e rrok periudhën 1932-1999. Teksti përmban shkrimet kushtuar jetës dhe veprës së Eqrem Çabejt, të botuara në gjallje të tij deri më sot, të botuara nga autorë shqiptarë e të huaj. Fillon me njësinë bibliografike: Agalliu, F.: Eqrem Çabej - studiues në zë i gjuhës dhe i kulturës së popullit tonë. - “Gjuha jonë”, Tiranë, 1990, numër 3, f. 87-91 e përfundon me njësinë: Zojzi, Rr.: Eqrem Çabej, “Disa eufemizma të shqipes”/ Einige Euphemismen der albanischen Sprache./- “Demos”, Berlin, 1962, nr. 2, f. 172.

Duke qenë kjo bibliografia e parë për veprën shkencore të profesor Eqrem Çabejt, ajo tërhoqi vëmendjen e shumë studiuesve, sepse sillte edhe punime të panjohura për Çabejn, të botuara ndërmjet dy luftërave botërore. Por, teksti e kishte një mangësi: nuk e përfshinte veprën e Çabejt të botuar edhe në Kosovë, ku pati ndikim të madh në fushën e gjuhësisë e në kulturën gjuhësore shqipe në përgjithësi.

Kjo Bibliografi është pasuruar me treguesin alfabetik të autorëve, treguesin e titujve të shkrimeve që i kushto-


hen figurës dhe veprës shkencore të E. Çabejt si autor, treguesin e titujve të shkrimeve për veprat ku Çabej është bashkautor, treguesin e titujve të shkrimeve të tjera për Çabejn, treguesin e titujve të periodikut, të revistave e të veprave ku janë botuar shkrime për Eqrem Çabejn dhe literaturën e përdorur.

Bibliografinë e ka botuar “Camaj-Pipa” në Shkodër më 2000, dhe ka 131 faqe në format 20 x 12 cm.

PROF. DR. JUP KASTRATI, BIBLIOGRAFIA E PROFESOR EQREM ÇABEJT 1929-1981

Ky tekst ka dalë në përkujdesjen e Begzad Baliut, botim i plotësuar i botimit të Tiranës më 1981. Bibliografia është shoqëruar me dy tekste hyrëse: Me rastin e botimit të M. Kastratit dhe Bota shkencore e Profesor Eqrem Çabejt të B. Baliut.

Teksti përfshin 228 njësi bibliografike të vjela nga periodiku shqip dhe i huaj gjatë viteve 1929-1981. Teksti fillon me njësinë “Poezia e Lasgush Poradecit”, botuar në “Gazeta



e re", Tiranë, 22 shkurt 1929 e përfundon me shkrimin "Për pastërtinë e gjuhës", botuar në "Gjuha jonë", viti I, nr. 1. f. 36-47 në Tiranë, 1981 (Ribotim). Shih nr. 222/1979).

Në ballë të tekstit bibliografik gjenet shkrimi Bibliografia e bibliografisë me 21 njësi bibliografike, që nga punimi i Idriz Ajetit, Veprimtaria shkencore e Prof. Eqrem Çabejt deri te libri Bibliografi e kritikës letrare shqiptare të Isak Shemës e Ibrahim Rugovës.

Lëndën për këtë bibliografi Jup Kastrati e ka vjelë nëpër biblioteka, arkiva, botimet bibliografike e burimet e tjera vendëse e të huaja. Bibliografia është e plotë. Titujt shqip janë dhënë në përkthim në gjuhët e huaja. Dhe anasjelltas. Teksti i përket bibliografisë kronologjike.

Ndryshe nga botimi i parë, botimi i përgatitur nga B. Baliu, del më i pasur me njësi dhe shtojca që e rrisin mendimin kritik të Eqrem Çabejt, që, këtu, botohen për herë të parë.

Ribotimi i kësaj bibliografie është bërë në prag të Konferencës shkencore me rastin e 95-vjetorit të lindjes së profesor Çabejt, organizuar në Universitetin e Gjirokastrës.

Bibliografia ka treguesin e emrave, treguesin e vendeve, shkurtesat etj. Ajo ka 126 faqe shtypi dhe është botuar në format 20 x 14 cm. Është botuar nga Gjumnazi i filologjisë "Eqrem Çabejt", Prishtinë, 2003.

BEGZAD BALIU, ÇABEJ I : BIBLIOGRAFI E STUDIMIT TË VEPRËS SË ÇABEJT NË KOSOVË 1952 - 2002

Autorë i disa kumtesave, recensioneve, teksteve shkencore e bibliografike, përkatësisht të parës monografi shkencore në fushë të bibliografisë ndër shqiptarët, Begzad Baliu hartoi edhe një bibliografi tjetër me interes: "Bibliografi e studimit të veprës së Çabejt në Kosovë 1952 - 2002".

Kjo është një bibliografi e plotë të shkrimeve të Çabejt në Kosovë deri te



Eqrem Çabejt (1908 - 1980)

artikujt periferikë, të domosdoshëm, me qëllim të njohjes sa më të mirë të personalitetit të Eqrem Çabejt: si rezyme apo versione të shkurtuara të kumtesave të lexuara, të pabotuara më parë, letërkëmbime ndërmjet studiuesve nga Kosova e Çabejt, që hedhin dritë në anë të panjohura të marrëdhënieve të studiuesve tanë në vitet '70, dokumente për përpjekjen e studiuesve tanë për krijimin e institucioneve shkencore me emrin e profesor Çabejt etj.

Teksti përfshin 666 njësi bibliografike të vjela nga botimet për Eqrem Çabejn: referime, trajtesa, diskutime, letërkëmbime, urime, përshëndetje, përkushtime etj., kushtuar jetës, veprës e personalitetit të Eqrem Çabejt.

Bibliografisë i prin një Hyrje e mendimit shkencor të veprës së profesor Çabejt në Kosovë e më gjerë, Baliu arrin në tri përfundime: a. Prej studimeve të deritashme dhe prej rezultateve të arritura, nuk është vështirë të konstatohet se, për veprën e profesor Çabejt, do të vazhdohet të shkruhet për shumë arsye edhe më tej; b. Vepra e Çabejt, në dorëshkrim, vazhdon të botohet në Tiranë e në Prishtinë, ndër- sa ajo e botuar më parë, me të njëjtin

intensitet, vazhdon të ribotohet. Horizonti i pritjes së rezultateve nga vepra e tij nuk ka rënë; c. Edhe më tej vepra e tij, madje jo vetëm gjuhësore, vazhdon të identifikohet me rezultatet më të larta të studimeve albanologjike.

Kjo Bibliografi fillon me njësinë: A[bazi], A[dem], "U zbulua busti i kolosit të gjuhësisë shqiptare E. Çabejt", Zëri, e përditshme, 23 maj 2002, f. 16 e përfundon me njësinë: Zymberi, Abdullah, "Rrjedhorja leksikore nga Buroja e Drenicës, mbështetur në rrënjorët etimologjikë të Çabejt". Kumtesë e lexuar në Sesionin shkencor, 1998.

Bibliografia është hartuar me përkushtim, sipas parimit de vizu, mbi bazën alfabetike germë për germë dhe i përket bibliografisë retrospektive. Ajo iu referohet të gjitha burimeve të mundshme, duke plotësuar njësinë edhe me pjesë të tëra të hyrjeve, teksteve në boks (gazeta), rezymeve në gjuhën shqipe apo në ndonjërin prej gjuhëve të huaja, botimeve shkencore etj. Nga ky tekst bibliografik krijohet ideja e plotë për kontributin e profesor Çabejt në fushë të albanologjisë në përgjithësi dhe në fushë të gjuhësisë, letërsisë, folklorit, historisë etj. Prej veprës së tij, shumë lehtë, krijohet mendimi për ndikimin që ka bërë Eqrem Çabejt në jetën tonë shkencore, arsimore, kulturore e mendore në rrethet shkencore të shkollës shqipe e në qendrat ndërkombëtare të albanologjisë.

Bibliografia ka treguesin e autorëve, treguesin i emrave brenda tekstit, treguesi i veprave dhe botimeve të veçanta, treguesi i gazetave dhe revistave shkencore, treguesi i diskutimeve, treguesi i kumtesave, treguesi i kartolinave, treguesi i letrave dhe treguesi i rezymeve.

Bibliografinë e ka botuar gazeta javore "Focus" e Prishtinës më 2006. Ka 270 faqe, në format 20 x 14 cm.

BIBLIOGRAFIA NË SHËRBIM TË PUNËS KËRKIMORE-SHKENCORE



GJON BERISHA

Cdo burim që studiuesi regjistron në shërbim të punës shkencore, qofshin këto të natyrës dëshmuuese empirike, të asaj historike e teorike, të dhëna nga terreni apo arkivat, hyjnë në atë që quhet bibliografi. Studiuesi i sotëm që merret p.sh. me një fushë të caktuar të historisë shqiptare, duhet që krahas punëve të tjera të merret shumë me gjurmimin e burimeve të shkruara të natyrës teoriko-historike dhe të asaj empirike; pra këto që kërkon mund t'u takojnë kohëve të kaluara ose dhe të sotmes dhe varianteve nga më të ndryshmet, ndoshta edhe nga ato që sot janë zhdukur krejtësisht, ose që mbijetojnë në forma tepët të evoluara e të ndryshuara.

Pra për këto burime të shkruara duhet të krijojë skedarët apo folderët bibliografikë, me klasifikim e grupim në përkim me qëllime të caktuara. Kjo bëhet nga që jo të gjitha burimet bibliografike do t'i shfrytëzojë e t'i skedojë menjëherë. Pikërisht në këtë trajtesë të shkurtër, do të bëjmë fjalë për rolin dhe rëndësinë e hartimit të bibliografisë në fund të punimit të magistraturave, doktoraturave dhe

punimeve të tjera shkencore.

Themi se një punim shkencor apo diplome gjithmonë duhet të ketë në fund një bibliografi, sado të hollësishtme e të sakta të kenë qenë referencat e të dhënat të shënimit. Nuk mund ta detyrojmë lexuesin që të kërkojë faqe për faqe informacionin që i intereson.

Për disa punime bibliografia është një shtojcë e dobishme, por jo e një rëndësie vendimtare, për disa të tjera bibliografia mund të përbëjë pjesën më interesante. Të mos flasim pastaj për punime krejtësisht bibliografike të tipit p.sh. Studime mbi veprën e "X" autorit gjatë viteve "X-Y", ku natyrisht bibliografia nuk është më një mjet ndihmës, por një pikësynim.

Hartimi i bibliografisë, mënyra e kërkimit të saj, klasifikimi për përdorim, janë një mjeshtëri e veçantë e punës kërkimore-shkencore, të cilës duhet kushtuar kujdes i veçantë.

Në bërjen e bibliografive të përgjithshme ose të veçanta, për tema që i interesojnë studiuesit, ka disa rregulla, kode të veçanta, sisteme klasifikimi që studiuesi duhet t'i dijë, qoftë në hartimin e bibliografive të tij, qoftë edhe për përdorimin e skedarëve në biblioteka e në arkiva, për t'i gjetur ato burime që i interesojnë. Këto rregulla, zakonisht ndryshojnë sipas vendeve dhe sistemeve të shkollimit, e që zakonisht i vendosin universitetet e caktuara për studiuesit e tyre. Rregullat dhe kodet e bibliografive të ndryshme, për t'i përdorur ato me qëllime praktike, mësohen me anë të librave të posaçëm, manualeve, bibliografive të botuara dhe me anë të katalogëve bibliografikë. Por kjo duhet të mësohet shumë mirë edhe në praktikë.

Studiuesi që kërkon shumë burime në biblioteka, arkiva dhe në internet, mëson dhe kodet e klasifikimit.

Varësisht prej rregullave të ndryshme të hartimit të bibliografive në fund të punimeve shkencore, bibliografia na paraqitet në disa mënyra e që më kryesoret janë: radhitje alfabetike apo sipas Harvardit, alfabetike-kronologjike, tematike, sipas vendeve, sipas gjuhëve të ndryshme etj.

Në sistemin sipas radhitjes alfabetike, njësitë bibliografike radhiten sipas mbiemrit të autorit, duke vazhduar me emrin, titullin etj. Kurse, kur vepra ka më shumë se tre autorë, në radhitje alfabetike bëhet sipas fjalëve të para të veprës. Në këtë sistem radhitja bëhet duke e respektuar radhitjen alfabetike globale, apo shkronjë për shkronjë. Për radhitjen tematike, për bazë merren disiplinat e ndryshme shkencore: artistike, historike, sociologjike etj., por brenda disiplinës ka radhitje të veçanta për tema më të ngushta. Në këtë rast, brenda aspektit tematik, për disiplina të gjëra apo për tema të ngushta, po aty futet edhe ajo alfabetik.

Sistemin alfabetik-kronologjik përdoret në raste kur tërësia e shkrimeve të një autori në bibliografi radhitet në kronologji. Ta zëmë të gjitha punimet e studiuesit Aleks Buda, janë të radhitura në kronologji. Ky sistem i radhitjes së bibliografisë është i përcaktuar përveç të tjerash edhe nga mënyra e përdorimit të citimeve. Zakonisht, në këto raste, autori i punimit në fusnota apo brenda në tekst përdor vetëm mbiemrin e autorit dhe vitin e botimit [p.sh. Buda, 1972; Buda, 1984, etj.]. Te ky sistem, hartimi i bibliografisë bëhet i domosdoshëm. Në këtë bibliografi,

përveç të tjerash qëllimi i hartimit të saj është që shkrimet në kronologji duhet studiuar, për të vërejtur aty ndër të tjera evolucionin e mendimeve, të ideve, të zbërthimeve të ndryshme të bëra nga një autor a një grup autorësh që janë marrë me të njëjtën temë për një kohë të gjatë.

Një formë tjetër e radhitjes së bibliografisë, është radhitja sipas vendeve të ndryshme (krahina, vende malore a bregdetare, shtete të ndryshme), ku për bazë merret gjeografiku. Ky sistem më së shumti përdoret në raste kur studimi ka të bëjë me hapësira gjeografike, si p.sh., në një punim diplome ku për qëllim bazë ka studimin e Historisë së Evropës, në këtë rast bibliografia, përveç formave të tjera mund të radhitej edhe sipas shteteve (sistemit gjeografik) duke e respektuar përbrenda sistemin alfabetik. Në fund të disa studimeve ndodh jo rrallë që të gjejmë bibliografi sipas gjuhëve edhe pse një sistem i tillë nuk është edhe aq praktik për përdorim.

Pa marrë parasysh se shpesh herë krijohen njëfarë lloj dublifikimi në mes shënimeve në fund të faqes (fushnota) dhe njësive bibliografike në fund të punimit (të njëjtat vepra të cituara te shënimet, do të jenë përsëri te bibliografia në fund të punimit), nuk duhet menduar që bibliografia në fund të punimit është e panevojshme. Kjo bibliografi përfshinë me një vështrim materialin e konsultuar si dhe ofron informacione të përgjithshme mbi literaturën e përdorur, prandaj do të ishte mundim i madh për lexuesin ta detyrojmë të hapte punimin faqe për faqe.

Përveç kësaj, bibliografia në fund të punimit jep informacione më të plota në krahasim me shënimet. P.sh. kur citohet një autor i huaj, në shënim mund të jepet vetëm titulli i veprës në gjuhën origjinale, ndërsa në bibliografi do të citohet edhe përk-

thimi i kësaj vepre, nëse ekziston. Tjetër, te shënimi zakonisht autori citohet me emër dhe mbiemër, apo me vetëm me mbiemër dhe shkronjën e parë të emrit dhe anasjelltas, ndërsa te bibliografia ai do të gjendet i radhitur alfabetikisht sipas mbiemrit dhe emrit të plotë. Gjithashtu, nëse një artikull është botuar për herë të parë në një revistë shkencore dhe pastaj është ribotuar në një vepër kolektive, te shënimi mund të citohet vetëm botimi i dytë bashkë me faqen e veprës kolektive, ndërsa te bibliografia duhet vënë, para se gjithash, botimi i parë. Jo rrallë ndodh që është cituar vetëm titulli i revistës apo gazetës dhe nuk është dhënë as autori e as titulli i punimit, kurse në bibliografi kjo duhet të jetë e kompletuar me të gjitha të dhënat, si: autori i punimit, titulli dhe nëntitulli, emri i revistës apo gazetës, vendi i botimi, botuesi, vjetari, numri, viti dhe faqet e cituara. Në shënim ndodhë që të shkurtohen disa të dhëna, të eliminohet nëntitulli, vëllimi, përkthyesi, përgatitësi, botuesi (edhe pse nuk janë të preferuara këto shkurtime), kurse te bibliografia duhet dhënë të gjitha këto informacione.

Sa i përket shenjave të pikësimit, ato zgjedhën varësisht prej modelit të hartimit të bibliografisë, duke mos iu larguar shumë disa rregullave të caktuara. Po ashtu nuk është e preferuar që në radhitjen alfabetike të bëhet edhe numërimi i njësive, pra mjafton që të radhiten saktësisht alfabetikisht sipas mbiemrit të autorit, kurse punimet e të njëjtit autor po ashtu radhitën brenda për brenda sipas sistemit alfabetik global.

Sa i përket strukturës dhe ndarjes së bibliografisë, sidomos për një pjesë të shkencave shoqërore, praktikohet që renditja të bëhet: burime të pabotuara, burime të botuara dhe më pas literatura, e cila përbëhet nga botimet monografike, artikujt studi-

mor dhe në fund burimet elektronike.

Nga kjo që parashtruar më sipër, kuptohet se problemi ndryshon sipas llojit të punimit, por çështja themelore mbetet gjithnjë organizmi i një bibliografie, e cila të jep mundësi që të përcaktohen dhe të dallohen qartë burimet parësore nga burimet dytësore, studimet shkencore nga materialet më pakë të besueshme

Kërkimi shkencor korrekt kërkon nga studiuesi një gjurmim të kujdesshëm për të dhënat bibliografike jo vetëm shqiptare, por edhe nga ajo me karakter krahasues në mes popujve të ndryshëm.

Eksplorimi për temën përkatëse është një anë e domosdoshme, por shumë rëndësi i duhet dhënë hartimit të një bibliografie shkencore të gjerë e të grupuar sipas normave e klasifikimeve që kërkohen në shkencë. Kjo literaturë, do siguroar, lexuar e përthithë me kujdes në dobi të kërkimit shkencor. Kjo kërkon shumë mundim, por është një veprim i domosdoshëm, nëse dëshiron të shkruash me kompetencë, për të qenë një studiues i kualifikuar me kuptimin e vërtetë të fjalës. Kur nuk i dimë burimet shkencore të shkruara më parë për një temë të caktuar, mund të shprehemi në atë temë ide që u ka kaluar koha, që janë të vjetruara e nuk i përgjigjen aspak të vërtetës.

Në fund të fundit, varësisht prej modelit të zgjedhur për hartimin e bibliografisë, në fund të studimit, synimet e një bibliografie duhet të jenë që të identifikojë saktë veprën të cilës i referohet; ta lehtësojë gjetjen e saj dhe të krijojë përshtypjen te lexuesi se e njeh gjithë bibliografinë lidhur me temën e caktuar.

Dhe krejt në fund, serioziteti dhe cilësia e hartimit të bibliografisë në fund të punimit, është një nga treguesit e vlerës së vetë punimit.

LIBRI MIKROMODEL KOMUNIKUES

/vijon nga ballina/

Me kulturë fisnore Arnhajm ka parasysh mbylljen në rrethe të ngushta lokale të përmbajtjeve krijuese, të cilat, të tilla, janë vetëm pjesë e një konsumi dhe vlere fisnore.

Shumë kohë më vonë, grekët e vjetër do ta mendojnë shkrimin vetëm si vazhdim i fjalës (të folurit). Roli komunikues në këtë shkrim zë vendin primar. Jo lehtësisht, shkrimi krahas këtij funksioni, nis të marrë edhe një karakteristikë shtesë që i pranohet, madje jo pa ndrojtje, atë të modelimit të kulturës njerëzore. Shkrimi merr elementet e vetë esencës së kulturës njerëzore. Kompleksiviteti i temës, fjalës dhe shkrimit në këtë kontekst, e raportit të librit me televizionin, sa kalon koha, po komplekset shumë e më shumë. Problemi metodologjik nuk mund të shmanget, se referencën e medias ia dedikojnë edhe librit teoricienë të shumtë, sociologë, komunikologë dhe letrarë. Libri edhe bën pjesë në sistemin e madh të medias, por nuk është i tëri media. Jo së paku identifikim konceptual me median-zhurnalizmin.

A mund të pajtohem me vlerësimin e Borhesit për librin kur shkruan se të gjithë njerëzit shkruajnë një të vetmin libër të madh - literaturë? Libri që është një strukturë elite e komunikimit herëherë, në periudhën e medializimit individual dhe kolektiv, a ka humbur këtë element pikërisht nën presionin drastik të industrisë mediale? Do kujtuar se Emil Zhirarden - gazeta me më shumë tirazh në Evropë në vitin 1850, thaujse rastësisht filloi të botojë në vazhdimë një roman. Kjo ishte një formë e parë e tillë, një vepër letrare të fillojë të botohet, përpara se në libër, në faqet e gazetës. Më vonë, romanet u shtuan dhe ata botoheshin në vazhdimë dhe shtypi po

kështu zgjeroi përmbajtjen dhe krahas kësaj edhe dimensionin e komunikimeve masive. Tash libri gjendet në duar të lexuesit edhe pa përfunduar procesi tipografik. Nuk duhet të presë lexuesi që një libër të dalë i tërë nga një shtëpi botuese, për ta pasur mundësinë që ta lexojë. Teknologjia mediale ofron mundësi të shumta komunikimi dhe për të pasur një hapësirë më të gjerë rreth kësaj mundësie, duhet përmendur format e ndryshme të qasjes që i ofrohen lexuesit paraprakisht si: Botimi i pjesshëm përpara se të dalë një vepër, botimi i pjesshëm mbas daljes së veprës, përkthimi, përpunimi për nevoja të tjera - radio, televizion, film, teatër-mikro-kopje, pllaka, shirita magnetofonibotime xhepi, botime të lira, reprinted, botime shkollore, huazime të librit për interesa komerciale dhe jokomerciale, antologjitë dhe botimet speciale, fotokopje, multimedia - interneti. Janë këto shumë nga format që mundësohen nga teknologjitë moderne të komunikimit, përmes të cilave libri mbërrin i pjesshëm apo i plotë, në formën e autoriale apo i përpunuar, te publiku i gjerë mediatik. Kjo gjerësi e shtrirjes teknologjike kishte frikësuar sociologë dhe kulturologë, të shohin me shumë pesimizëm të ardhmen e burimit më të madh të dijes, librit. Madje, mundësinë e fundit të librit në proceset e reja tekniko-teknologjike e kishin paraqitur edhe disa nga teorikët më të njohur të komunikimeve në shek. XX, ndër të cilët edhe Marshall Mekluhan. Mu duke pasur parasysh gjithë potencialin që ofron kjo teknologji mediatike, duke pasur parasysh veçmas televizionin, ai në vitet '60 të shekullit të kaluar, prognozonte se „fundi i librit do të mbërrinte në vitin 1980“. Fatbardhësisht, kjo prognozë e tij nuk u realizua. Mbas vdekjes së Mekluhanit më 1980 edhe një qendër

që ishte në Toronto për kulturë dhe teknologji me emrin e tij, u shua, duke simbolizuar edhe shuarjen e prognozës sa të pazakonshme po aq edhe të pakëndshme.

Libri, i heshtur, iu qas botës edhe si një mjet i komunikimit masiv pa humbur nga presioni i arritjeve teknologjike. Përkundrazi, fitoi, jo vetëm duke u paraqitur pjesë apo gjithë përmbajtja e saj në këto teknologji, por edhe duke mundësuar marketing dhe informacion të shpejtë dhe të plotë për secilin botim që del në tërë rruzullin tokësor. Fjala vjen, tashti bibliotekat përmes sistemeve kompjuterike, në të gjitha kontinentet dhe vendet, mund të këmbejnë, jo veç informacionet, por edhe librat dhe gjithë çfarë paraqet vlerë të shkruar.

Sociologë, komunikologë, antropologë, psikologë etj., kanë shtruar nga kënde të ndryshme raportin ndërmjet librit dhe televizionit, alarmuar me një ton dramatik nismërisht nga Mekluhani. Cilat janë ngjashmëritë, plotësimet dhe cilat dallimet dhe mangësitë e secilit veç e veç? Do pasur parasysh se format e veprimit medial që nga modellet më delikate dhe deri tek ato më agresive dhe të vrazhda, ia shtrojnë medias etiketën e mungesës së delikatesës së librit. Media nuk e mban vlerën e librit që është mjet tipik komunikimi shumë delikat, sikur që është edhe piktura. Mund të jetë, por prore e më rrallë gjendet në atë të medias, me të cilën sot nënkuptohet civilizimi i krizës publike.

Nëse për pikturën mund të thuhet, ndërsa për librin saktësohet të jetë një mikromodel kulturor, televizioni paraqet një makromodel kulturor, po aq informativ dhe financiar. Derrida potencialitetin dhe njëdimensionalitetin e shkrimit dhe librit, dhe përkundër kësaj, televizioni është shumëdimensional.

Libri ruan shumë nga vlerat dhe shkathtësitë krijuese dhe historike të njerëzimit, e televizioni prodhon jo vetëm këtë dimension vlere historike, por edhe merr pjesë në modelimin e realitetit dhe irlitetit, vizioneve dhe antivizioneve nga më të ndryshme.

Ndërsa me librin është i lidhur kryekreje fenomeni i leximit, dhe sumerët këtë e bënë në një mënyrë fatlume, duke bashkuar shkrimin dhe librin në një strukturë ambienti, pra duke krijuar edhe institucionet e para për shikim-leximin dhe për mundësi të abstrahimit logjik në një shkallë më të lartë, konsumi medial televiziv tashti, të shumtën, kapërcen këtë model, se ngrit fenomenin e shikimit dhe kjo nënkupton se, nuk është e domosdoshëm, të jetë aty vetëm akti i leximit. Do pasur parasysh edhe një media tjetër shumë të fuqishme, radion dhe telefonin - mobifonin, të cilat ekstremizojnë fenomenin e dëgjimit, ndërsa në televizion kjo bëhet edhe krahas shikimit.

Ndërsa librit i atribuohen më tepër cilësi arsimore dhe estetike, televizionit i bie barra më shumë për të informuar dhe për të argëtuar. Në fakt, informimi dhe argëtimi, që mbërrijnë të mbijetojnë globalisht në saje të mediave, mënjanojnë vlerat e thella dhe stabile, të cilat kohë të gjatë ishin ëndërruar, duke e pasur referencë librin. Prodhimet mediale kryesisht dominohen nga trivialiteti dhe pllakaviteti, andaj janë për një përdorim më të shkurtër, të përkohshëm. Përkundër kësaj, shikimi dhe përjetimi i një përmbajtjeje televizive, fjala vjen, është global, shikohet në të njëjtën kohë nga miliona njerëz, emocionet janë të një çasti dhe reagimet shpesh nga këto përmbajtje prodhojnë veprime dhe pasoja kolektive, uniforme, madje edhe globale. Libri prodhon reagime individuale, sporadike, ky është komponenti kryesor. Pastaj libri nuk kishte dhe nuk ka as e sot funksionin e fuqishëm distancues sa e përçon televizioni.

Si do ta interpretojë praktikën njerëzore, një konsumuese libri edhe si një konsumues medial? A do të jetë ky interpretim me pika të afërta apo do të jetë krejt i dallueshëm? Në esencë mbas leximit, libri interpretohet me elemente të shumta simbolike, ndërsa përmbajtja mediale edhe po u interpretua, shfrytëzon pak elemente simbolike. Mbas leximit njeriu imagjion mundësinë e interpretimit po mbas shfrytëzimit të përmbajtjeve mediale, edhe bëhet aktor i dramës, d.m.th, nga roli interpretues merr edhe rolin përjetues.

Librin nuk mund ta trajtojë lexuesi si produkt të vetin, vetë ai të bëhet një pjesëmarrës në krijimin e tij, megjithëse domosdoshëm duhet të ekzistojë raporti dinamik shkrimtari-lexuesi për të funksionuar vepra, pikërisht siç e shpreh Sartri, akti i shkrimit nënkupton edhe aktin e leximit. Televizioni e zgjeron më tej këtë pikëpamje se shumë nga publiku këtë sistem e trajtojnë pjesë të kreacionit apo veprimit të tyre. Një biznesmen me përmbajtjet e marketingut është krijues i programit medial, madje edhe një amator që ka incizuar një storie në një dasmë me kamerën e tij, ku ndodh një ngjarje e veçantë argëtuese me nusen a dhëndrin, bëhet pjesë e ndërtimit të programit medial. Publiku është pjesëmarrës masiv në programet televizive.

Libri kërkon arsimim dhe intelektualizëm më të madh, mbasi i përket modelit elit kulturor, ndërsa përmbajtjet televizive mund të konsumohen edhe nga një njeri, i cili nuk di të shkruajë dhe as të lexojë. Nuk i nevojitet një standard intelektual i veçantë për të qenë pjesë e reciprocitetit medial, ndërsa me librin ai nuk mund të vë fare kontakt, përveç të jashtëm, me shikim, pa mundur të kuptojë çfarë fshihet brenda. Televizioni, prandaj nuk i përket vetëm modelit elit kulturor, por edhe atij masiv, madje kryesisht masiv, duke pasur parasysh pikërisht numrin e madh të audiencës dhe nivelin e ndryshëm arsimor.

Libri është një pikë nismëse për studiues, për të thelluar mendimin kritik, është vetë pika nismëse e krijimitarisë, dhe e gjetjes së mundësive të shprehjes së origjinalitetit dhe të kreativitetit. Pa librin nuk mbërrin një studiues të jetë serioz, ndërsa televizioni nuk i përket objektit që është i domosdoshëm për të qenë dikush i rëndësishëm në jetën intelektuale, jo në kuptimin promociional, por atë të rezultateve. Një njeri që kalon shumë kohë me librin, ka një synim më të largët, të jetë dikush që çmohet, ndërsa miliarda shikues të televizionit nuk vuajnë fare nga një preokupim i tillë.

Eskarpie mbi këtë bazë ndante librat në funksional, me të cilët identifikon ata arsimor-profesional dhe jofunksional, librat estetik, letrar. Përkundër librit që megjithatë nuk mund të gjykohe se nuk ka shumë përmbajtje arsimore, televizioni vlen si mjet i dyzuar, edhe funksional me përmbajtjet arsimore-profesionale, ato që tregojnë dhe aftësojnë njerëzit të punojnë dhe njëherësh, po kështu edhe jofunksional me përmbajtjet artistike, të cilat nuk kryejnë rolin e të parit. Por, duke shikuar njeriun me libër, ai zgjon një ndjenjë respekti, kulture. Libri një produkt simbolik dhe tregu përcakton statusin social të njeriut, thekson aftësinë krijuese të tij, ndërsa televizioni nuk përcakton statusin social, nuk përcakton as aftësitë krijuese të njeriut. Një libër në dorën e njeriut d.m.th njeri i arsimuar. E shohim një njeri duke mbajtur televizor në dorë, nuk vepron më ndjenja e mëparshme sikur në rastin e librit. Televizioni më tepër shquan kuptimin e një mjeti, objekti, teknike. Libri, pavarësisht se edhe ai është nga kopertinat dhe letra brenda me shkronjat dhe, ndonjëherë edhe vizatimet e fotot, nuk mbetet simbolizëm vetëm i objektit. Në të shihet simboli i civilizimit. Në televizor shihet simboli teknologjik.

/vijon në numrin e ardhshëm/

QYSH U SHKATËRRUAN LIBRAT?!

Ky tekst është nxjerrë dhe përpunuar nga libri "Kuriozitetet e literaturës" i botimit të vitit 1790, i cili më pastaj ka pasur ribotime të shumta.

ISAAC D'ISRAELI

Kastelvetroja, komentatori italian i Aristotelit, pasi që kishte dëgjuar se shtëpisë së tij i ishte dhënë flaka kishte vrapuar i lemeritur nëpër rrugët e qytetit, duke u bërë kalimtarëve, alla Poetica! alla Poetica! te Poetika! te Poetika! Në atë kohë ai ishte duke e shkruar komentin e tij për "Poetikën" e Aristotelit.

THESARET e shumta të letërsisë së antikitetit kanë vuajtur shumë nga shpirtligësia e njerëzve, po aq sa kanë vuajtur edhe nga vjetërsia, koha e ekzistencës së tyre. Është tashmë e njohur se pushtuesit, që në momentin e fitores apo edhe gjatë fushatës së pakursyeshme të tyre, nuk kanë qenë të kënaqur vetëm me shkatërrimin e njerëzve, por gjithashtu kanë zgjeruar hakmarrjen edhe ndaj librave.

Historia antike regjistron se si persianët, nga urrejtja ndaj religjionit të fenikasve dhe egjiptianëve, kishin shkatërruar librat e tyre, të cilat, sipas venerimeve të bëra nga Eusebiusi, kishin qenë në numër të konsiderueshëm. Lidhur me këto çështje është ruajtur edhe një anekdotë tashmë e njohur e që lidhet me bibliotekat e Greqisë së lashtë ku theksohet se është djegur Gnidusi nga ana e një sekti të Hipokratit, sepse gnidianët kishin refuzuar t'i përcjellin dhe aplikojnë doktrinat e mësuesit të tyre. Kjo anekdotë mund të konsiderohet si e dyshimtë, por e vërteta shpeshherë i ka asgjësuar librat!

Romanët nga ana tjetër i kanë djegur librat hebraike, librat e krishterëve dhe të filozofëve. Hebrejtë pastaj kanë dje-

gur librat e krisianëve dhe paganëve, ndërsa kristianët nga ana tjetër kanë djegur librat e paganëve dhe hebrejtë. Pjesa më e madhe e librave të Origenit dhe të heretikëve të tjerë janë djegur në mënyrë të vazhdueshme nga ana e palës ortodokse. Giboni me patetizëm e përshkruan bibliotekën e zbrazët të Aleksandrisë, pasi që atë e kishin shkatërruar kristianët. "Biblioteka e çmueshme e Aleksandrisë ishte plaçkitur ose shkatërruar dhe për së paku njëzet vjet më vonë mbetja e raftëve të zbrazëta të saj kishte prekur keqardhjen e çdo spektatori, mendja e të cilit nuk ishte errësuar tërësisht nga prejudikimi religjioz. Kompozicionet e gjenive antikë, shumica prej të cilave pakthyeshëm janë zhdukur, mund të shpëtonin nga shkatërrimet e idiolatrisë, për kënaqësi, porosi e mësimdhënie për kohët pasuese; dhe se zelli apo kopracia e kryepeshkopëve mund të ishte ngopur nga plaçka e madhe, e cila rridhte si pasojë e fitores së tyre".

Gjithashtu, kemi edhe rrëfimin kurioz të Niketë Koniatës që lidhet me shkatërrimet e kryera nga kristianët e shekullit të trembëdhjetë në Konstantinopolë, rrëfime të cilat janë censuruar gjatë botimeve të shtypura të mëvonshme; por që si të tilla janë ruajtur nga Dr. Klarku. Ne nuk mund ta vijojmë tërësisht këtë histori të dhimbshme, hap pas hapi, pra të niketianëve patetikë, pa përjetuar ndjenjat e thella të indinjatës. Dr. Klarku veneron se turqit kanë kryer dëmtime të veprave të artit më shumë se kristianët barbarë të kësaj periudhe.

Leximi i Talmudit hebre është ndaluar me anë të shumë dekretëve të Perandorit Justinian, me anë të shumë dekretëve të mbretërve spanjollë e frëng dhe me anë të dekretëve të shumë papëve në vijim. Ishin dhënë urdhra që të gjitha kopjet e tij të digjen dhe vetëm guximi dhe sakrifica e hebrejtë ka

mundësuar që ky liber të shpëtojë nga shkatërrimi, pra nga zhdukja. Në vitin 1569 dymbëdhjetë mijë kopje të tij janë hedhur në flakët e Kremonës. Xhon Reuçlini kishte intervenuar që kjo gjëmë universale e zhdukjes së talmudëve të ndalej. Si pasojë e kësaj ai kishte fituar urrejtjen e murgjve si dhe ishte dënua nga Zgjedhësi i Mentit, por pas ankesës në Romë, ndëshkimi i mëtutjeshëm i tij ishte ndalur, kur edhe ishte marrë në konsideratë që tradita hebraike të mos shkatërrohej.

Pushtuesit gjithnjë së pari shkatërrojnë, me një zell të madh, regjistrimet nacionale të popullit që e pushtojnë, prandaj kjo u ka ndodhur edhe irlandezëve pasi që ata tregojnë humbjet e pakthyeshme të kujtimeve të tyre më të mira antike nacionale, të cilat invaduesit me sukses të madh kanë arritur t'i shkatërrojnë. E njëjta gjë thuhet ka ndodhur edhe gjatë kohës së pushtimit të Meksikës. Historia interesante e Botës së Re mund të mbetet përgjithmonë e paplotë, si pasojë e suksesit të pafat të misionarëve të parë, të cilët shumë vonë kishin arritur të bëheshin të ndjeshëm dhe të vetëdijshëm për gabimet fillestare



të tyre. Klavigero, historiani më autentik i Meksikës, në vazhdimësi e vajton këtë humbje tepër prekëse. Gjithçka në këtë vend sipas këtyre burimeve ishte e pikturuar dhe se piktorët aty ishin më bollëk sikur shkruesit në Evropë. Misionarët e parë, të dyshimtë në atë se paragjykimet ishin përzier në të gjitha këto pikturime e kishin sulmuar shkollën kryesore të këtyre artistëve, kishin mbledhur, në një vend tregu, një mal të tërë të këtyre pikturave, pra punimeve artistike, dhe ua kishin dhënë të gjithave flakën, duke e kthyer e varrosur në hi kujtesën e ngjarjeve më të rëndësishme të këtij vendi. Pas kësaj, të vetëdijshëm për gabimin e bërë, ata ishin përpjekur të mbledhin informacione nga goja e indianëve, por indianët kishin heshtur të indinjuar: kur ata kishin dashur pastaj t'i mbledhin ato pak mbetje të këtyre historive të pikturuara, patriotët meksikanë zakonisht i varrosnin ato në vende të fshehta, pra veprat e mbetura të vendit të vet.

Fjala e Kalifit Omar e përhapur në krejt mbretërinë, pas marrjes në dorë të Aleksandrisë, se Kurani përmbante gjithçka që mund të jetë e duhur për t'i besuar dhe gjithçka që duhet për ta ditur, kishte bërë punën e vet. Sepse, ai kishte urdhëruar që të gjitha librat që gjenden në Bibliotekën e Aleksandrisë të shpërndahen, të dërgohen te pronarët e hamameve, rreth 4000 sosh, që të përdoren për nxehjen e shporeteve të tyre gjatë një periudhe gjashtëmuajore, hap që edhe paradokset moderne mund ta mohojnë. Por, ky rrëfim nuk do të mbetet i përveçëm edhe nëse do të ishte tërësisht i saktë: ky rrëfim thekson më shumë karakterin e një fanatiku, barbari dhe një njeriu me kokë të ngrirë. Një ngjarje e ngjashme ka ndodhur edhe në Persi. Kur Abdullahu, i cili në shekullin e tretë të epokës muhamedane e kishte qeverisur Korasanin, ishte njoftuar në Nishapor me një dorëshkrim, i shfaqur ky si kuri-ozitet letrar para tij, ai kishte kërkuar ta dijë titullin e tij. I ishte thënë se ka të bëjë me rrëfimin për Uamikun dhe Ozran, krijim ky nga poeti i madh per-



sian Noshirvani. Me këtë rast, Abdullahu kishte hetuar se kjo nuk ishte libra e vendit të tij, sepse njerëzit e tij nuk kishin të bënin asgjë me ndonjë libër tjetër përveç Kuranit dhe se ky kompozicion që përmbante idhujtari iu duk i neveritshëm. Prandaj, ai, jo vetëm që mohoi ta pranonte atë vepër, por urdhëroi që ajo të digjet në praninë e tij. Pastaj, nxori edhe proklamatin, që komandonte që të gjitha dorëshkrimet që mund të gjendeshin në rrethin e qeverisjes së tij të digjeshin. Kështu që, shumica e poezisë së vjetër perse ishte zhdukur më anë të këtij dekreti fanatik. Kardinal Ksimensi duket se ishte hakmarrë pakëz në Sarakenë, sepse kur e kishte zaptuar Grenadën i kishte hedhur në flakë pesë mijë kuranë.

Rrëfimi vijues ka të bëjë me mesharin spanjoll, i cili quhet Shën Isidori, rrëfim që nuk është pa kuri-ozitet. Gjatë luftërave morishe, të gjithë këta mesharë janë shkatërruar, përveç atyre që kanë qenë në qytetin e Toledos. Në këtë qytet, në gjashtë kisha kristiane, ishte lejuar praktikimi i lirshëm i besimit. Kur morët ishin përzënë disa shekuj më vonë nga Toledoja, Alfonsi i Gjashtë kishte urdhëruar që mesharët romanë të përdoshin në këto kisha; por njerëzit e Toledos kishin insistuar për t'i mbajtur mesharët e tyre tashmë të preferuar, të cilët ishin shkruar nga peshkopët antikë dhe të rishqyrtuar nga Shën Isidori. Ai ishte përdorur nga një numër i madh i shenjtvëve dhe pasi që ishte vërtetuar se ai kishte shpëtuar i

paprekur nga luftërat more konsiderohej se Alfonsi në raport me këtë libër ishte më tiran sesa turqit. Kontesti ndërmjet mesharëve romanë dhe toletanë kishte arritur deri në atë shkallë sa që për fatin e tyre kishte mbetur të vendosej me anë të një lloj lufte, sepse triumfi i mesharit toletan u konsiderua si thyerje e krenarisë së mesharit roman. Alfonsi e konsideronte këtë betejë si fuqi e trimëri të toletanëve dhe kishte dhënë urdhër për një agjërim dhe për përgatitjen e një zjari të madh rreth së cilit do të tuboheshin dhe të luteshin, e ku do të hidheshin në zjarr mesharët (jo njerëzit) e rendit tjetër. Por, prapëseprapë meshari i Shën Isidorit kishte triumfuar dhe se ky libër i çeliktë ishte lejuar që të mbetet libër ortodoks nga vetë Alfonsi. Kështu që njerëzit e mirë të Toledos ishin lejuar më në fund që të theksojnë lutjet e tyre në mënyrën që ishin mësuar me kohë. Megjithatë, kopjet e këtij meshari në sasinë e tij kanë mbetur shumë të rralla, sepse me kohë kur më askush nuk e kundërshtonte ekzistencën e tij, askush nuk kujdesej që ta lexonte atë. Kardinali Ksimenes kishte hasur në vështirësi të shumta për ta siguruar bile edhe një kopje, ku ka shtypur edhe një impresion të gjatë dhe ka ndërtuar një kapelë të koncentruar të Shën Isidorit, ku shërbimet mund të kryheshin për çdo ditë ashtu siç bënin kristianët e vjetër.

Nga anglishtja: Nysret Krasniqi

/vijon në numrin e ardhshëm/

KATALOGU DHE KATALOGIMI - PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT TË PROGRAMIT ALEPH 500 NË KOSOVË



BUKURIJE HALITI

Historia më e re e zhvillimit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, është e lidhur pikërisht me përpjekjet për automatizimin e shërbimeve bibliotekare, përpjekje kjo që kërkon investim në infrastrukturë e në resurse njerëzore - dhe që do të duhej të burojë nga një përkrahje edhe politike edhe financiare për bibliotekat dhe komunitetin bibliotekar.

Implementimi i Programit Aleph 500, përkatësisht i njërit prej moduleve kryesorë të këtij programi - Moduli të katalogimit, në BKUK dhe në Bibliotekat Ndërkomunale të Kosovës, është prova e parë që ka vënë rezultate të prekshme. Prandaj, ky rezultat ka pasuar me angazhimin për gjetjen e rrugëve dhe hapësirave të përbashkëta si të ndërtojme një rrjet unik bibliotekar - me njësi bibliografike të integruara të të gjitha bibliotekave të qendrave e llojeve të ndryshme, pra në një arkiv të madh që informon për krejt materialin bibliotekar që e ka Kosova.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, atëherë Biblioteka Popullore e Kosovës, ka bërë një

provë të pasuksesshme, për herë të parë, për digjitalizimin e njësive bibliografike në mesin e viteve '80-ta - projekti COBISS. (Pra, po flasim për përpjekjen e parë të kalimit të përpunimit të njësive bibliotekare nga skedat manuale në njësi që përpunohen në një program elektronik., ku janë përpunuar përafërsisht rreth 60000 njësi bibliografike). Kjo përpjekje e viteve të '80-ta, do të thotë të gjitha ato njësi të përpunuara - e gjithë ajo bazë e të dhënave ka humbur.

Biblioteka, pastaj nga viti 1999 deri në vitin 2003, përpos përgatitjes dhe pasurimit të katalogut manual, nëpërmjet skedave, i ka futur të njëjtat të dhëna, nëpërmjet një shablloni të ndërtuar nga stafi, në Word, njësi këto që nuk kanë arritur të konvertohen në programin Aleph 500, (Program që në më vonë do të instalohet në BKUK) për shkak të dallimeve mes shabllonit në të krijuar në Word dhe formatit MARC.

Nga viti 2004 - Ex-Libris, një sistem i integruar bibliotekar, përkatësisht produkti i saj Aleph 500, u implementua edhe në BKUK. Deri më tash Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka përpunuar në Modulin e katalogimit 50042 tituj, përkatësisht 73426 ekzemplarë. Të klasifikuara sipas llojeve të koleksioneve: në Fondin e Librave dhe Serieleve - 66197 ekzemplarë; Fondi i Rrallë dhe i Vjetër - 857 ekzemplarë; Koleksione të Veçanta - 3719 ekzemplarë; Biblioteka e Universitetit të Prishtinës - 2259 ekzemplarë.

Pra, njësitë bibliografike nga baza e të dhënave të BKUK-së ruhen

brenda llojeve të koleksioneve të BKUK-së dhe në Qendrën e Bibliotekës Universitare (Qendra e Bibliotekës Universitare, siç e dini, po përgatitet të jetë Biblioteka Qendrore e Universitetit të Prishtinës me degët e saja në gjithë qendrat e Kosovës).

Ecja me një ritëm të kënaqshëm e futjes, përpunimit dhe menaxhimit të njësive bibliotekare nëpërmjet këtij programi, motivoi stafin e BKUK-së për të hulumtuar mundësinë se si dhe çfarë mund të bëjmë për ta shtrirë rrjetin e këtij programi, përkatësisht të Moduli të katalogimit edhe në bibliotekat kryesore publike - në 7 qendra të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Gjiilan, Ferizaj, si dhe në disa fakultete të Universitetit të Prishtinës, si: në Fakultetin Filologjik dhe, së shpejti edhe në Fakultetin Teknik.

Zgjerimi i këtij programi (pas më shumë se 3 vjet jete në BKUK) ka marrë udhë. Ekziston tashme pajtimi dhe miratimi i dy ministrive të qeverisë së Kosovës; Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, për të përkrahur zgjerimin e rrjetit të Programit Aleph 500. Në këtë kontekst, janë bërë konsultime edhe me Rektoratin e Universitetit të Prishtinës, i cili ka shprehur gatishmërinë që të ndihmojë të krijohet rrjeti i bibliotekave universitare nëpërmjet instalimit të këtij programi në të gjitha degët e universitetit të Prishtinës.

Ekspertë nga stafi i BKUK-së, vitin e kaluar kanë marrë gjithë

informacionin për gjendjen në 7 bibliotekave ndërkomunale, nëpërmjet krijimi të një pyetësori që merr informacion të rëndësishëm, si: përpunimi i materialeve, llojet e koleksioneve, pasurimi i fondeve, rrjeti i internetit, niveli profesional i stafit, kushtet teknike.

Mbështetur mbi kritere profesionale, drejtuesit e bibliotekave publike kanë zgjedhur stafin për të nisur fillimisht trajnimet në fushë të katalogimit - trajnim që është zhvilluar udhëhequr nga stafi i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë anëtarë të stafit të bibliotekave ndërkomunale që, sipas një kriteri të përzgjedhjes nga drejtorët e këtyre bibliotekave, kanë njohuri kompjuterike dhe bibliotekare të dallueshme.

Nga ky trajnim, stafi i këtyre bibliotekave ka përfitur njohuri nga moduli i katalogimit (si përpunohet një njësi bibliografike në Formatin MARC në programin Aleph. Stafi ka përfitur njohuri edhe për tipet e koleksioneve, ndarjen e njësive në nënbiblioteka, konvertimin e të dhënave bibliografike dhe modifikimin e njësive sipas nevojave të secilës bibliotekë.

Pas këtyre përgatitjeve, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka filluar praktikisht zgjerimin e rrjetit në dy biblioteka, të cilat tashme i kanë futur njësitë e para në Modulin e katalogimit: BN e Prizrenit dhe BN e Prishtinës, kurse janë vendosur bazat testuese edhe në Bibliotekat ndërkomunale të Pejës, Gjakovës, Gjilanit, Mitrovicës dhe të Ferizajt. Në fazën e testimit, ky program është edhe në Bibliotekën e Fakultetit Filologjik, ndërsa së shpejti prite të instalohet edhe në Fakultetin Teknik.

Me krijimin e rrjetit, ka filluar

implementimi i këtij projekti. Tash, njësitë bibliografike nga baza e të dhënave të BKUK, janë në dispozicion për bibliotekat publike, (por edhe ato universitare – posa ky rrjet të shtrihet praktikisht në bibliotekat e UP-së) në mënyrë që ato të kenë qasje në marrjen e njësive bibliografike dhe konvertimin e saj sipas organizimit të koleksioneve të bibliotekave. Pra, njësitë e kataloguara nga BKUK do të 'kopjohen' nga bibliotekat dhe me ndonjë ndryshim të mundshëm rreth numrave të inventarit, lokacionit se ku gjenden njësitë e tyre, do të ruheshin në bazat lokale të secilës bibliotekë, ndërsa për bazën e të dhënave do të përkujdeset personeli i BKUK-së.

Me këtë po nis unifikimi i të dhënave bibliografike të këtyre bibliotekave në një bazë të madhe të të dhënave.

Kjo qasje jona për të hyrë fillimisht me modulin e katalogimit, ka pasur për synim që në secilën bibliotekë, të nisë 'endja' e këtyre të dhënave bibliografike të njësive, duke kursyer kohë për të gjitha bibliotekat, meqë një njësi e përpunuar vetëm mund të konvertohet, pa pasur nevojë të përpunohet nga fillimi. Për këtë, edhe përpunimi i koleksioneve do të përcillet sipas politikave që ka BKUK - të përpunohen koleksionet më aktuale për nga viti i botimit, duke zbritur poshtë nëpër vite në njësi bibliografike retrospektive - me prioritet koleksionin në gjuhën shqipe. Kjo do të krijojë lehtësi për bibliotekat publike që do të takojnë në katalogun tonë njësitë e përpunuara. Pra, njësia mjafton të përpunohet njëherë e pastaj nëpërmjet bazës së të dhënave të shpërndahet te bazat e të dhënave të bibliotekave që e pose-

dojnë atë njësi të përpunuar në BKUK. Kataloguesit do të mund të bëjnë konvertimin edhe në baza të tjera të të dhënave të bibliotekave të njohura botërore që mund ta kenë atë njësi në katalogun e tyre.

Në tërë këtë aktivitetet për zgjerimin e rrjetit, përkatësisht funksionimin e Modullit të katalogimit, në perspektivë do të duhej të përqendrohemi në:

- zgjerimin e rrjetit dhe funksionimin e tij, fillimisht në bibliotekat me frekuentim të madh të përdoruesve – kemi parasysh këtu - pos bibliotekave publike ndërkomunale edhe bibliotekat e fakulteteve të Universiteti të Prishtinës;
- lidhja e ngushtë e bazave lokale të të dhënave të të gjitha bibliotekave në një katalog të përbashkët dhe ruajtja dhe mirëmbajtja e tyre;
- aftësimi i vazhdueshëm i bibliotekarëve për një kulturë qasjeje në një katalog të përbashkët – për përpunim dhe kërkim;
- kontrolli i redaktimit të njësive nga një këshill profesional i kataloguesve;
- shkëmbimi bibliografik i të dhënave dhe i koleksioneve i të gjitha bibliotekave që janë në rrjet, duke harmonizuar politikat e pasurimit të koleksioneve;
- administrimi i bazës së përbashkët të të dhënave;

Në krejt këtë projektim se si do të duket nesër - në të ardhmen, ky integrim informacionesh e koleksionesh, mbetet të inkorporohen shumë faktorë institucionalë bibliotekarë e qeveritarë për të ndihmuar në finalizimin e këtij projekti shumë ambicioz në kushtet tona të infrastrukturës dhe të personelit. Mbesim me shpresë se ky projekt do të përkrahet nga institucionet qeveritare të Kosovës.

INFORMACIONI I NJËSIVE BIBLIOGRAFIKE NË FORMATIN MARC

Përshkrimi i të dhënave bibliografike në disa nga fushat e formatit MARC gjatë procesit të katalogimit në BKUK

JEHONA SHALA

Moduli i katalogimit (moduli bazë) është modul, i cili ofron mundësinë për regjistrimin e të dhënave që posedon libri (apo çdo lloj tjetër i materialit bibliotekar), prej momentit kur libri (materiali) bëhet pjesë e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Shablloni i këtij moduli, përkatesisht formati MARC, në të cilin përshkruhen të dhënat për njësi, është i përbërë nga shumë të ashtuquajtura fusha e nënfusha, ndërsa shumë nga këto, mbesin të "papërdorura" nga kataloguesit. Pra, në këtë kontekst, nuk kemi për qëllim për të shpjeguar fushat e Modullit të katalogimit, meqë shpjegimi për to ekziston në përshkrimin e rregullave të katalogimit në formatin MARC, dhe me shumë prej këtyre fushave tashmë kataloguesit janë *familjarizuar* (gjithnjë po flasim në kontekstin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës), por për të nënvizuar këtu disa nga 'kërkesat' që ato shfaqin e që ne nuk kemi arritur në mënyrë të plotë t'i përvetësojmë; mangësitë eventuale që paraqiten gjatë plotësimit të këtyre fushave. Pra, po shqyrtojmë disa nga problemet që lidhen me plotësimin e fushave në formatin MARC, që kërkojnë saktësi të përshkrimit të elementeve të njësive bibliografike, për shkakun se devijimi i përshkrimit të ndonjëres prej fushave të njësive (përshkrimi jo korrekt apo jo i plotë), e vë në lajthitje edhe përdoruesin/huazuesin, i cili bën kërkimin, ta zëmë, të një njësie libër në katalogun elektronik të BKUK-së. Në këtë kontekst, shtrohet problemi se sa janë mundësitë që një përdorues të mund

të gjejë njësinë që ai kërkon ose çfarë mundësisë i ofrohen përdoruesit për kërkimin (gjetjen) e një njësie në katalogun elektronik të BKUK-së.

Po i përshkruajmë, me këtë rast, disa nga fushat në të cilat kataloguesit do të duhej të përqendronin vëmendjen gjatë katalogimit të një njësie bibliografike. Një nga proceset fillestare të një kataloguesi është që të bëjë verifikimin e Numrit Standard për secilin libër që ka përpara gjatë procesit të përpunimit. Kjo fushë do të duhej të rishikohet, për të vërtetuar nëse është vendosur saktë Numri Standard i një njësie - pra fjala është për fushën / 020 / ose fusha e ISBN-së, në rastet kur librat janë në vëllime. Dhe, në rast se kataloguesi për verifikim e zgjedh kërkimin me ISBN, atëherë kërkimi rezulton me zero, sepse kërkuesi shënon vetëm numrin e ISBN-së, ndërsa në rastet kur libri është me vëllime, shënimi te fusha / 020 / bëhet në këtë mënyrë: 9992751363 [V. 1], shihet se në këto raste secili vëllim ka ISBN-ën e tij. Dhe, ky shënim i vëllimit në kllapa te mesme i shënuar në anën e djathtë të Numrit Standard i pamundëson kataloguesit (në fushën e kërkimit me Numër Standard), që ta kuptojë nëse libri është ose jo i kataloguar, prandaj edhe rezultati është *zero* dhe ky pamundësim i gjetjes së librit rrezikon duplikimin e të njëjtut libër brenda katalogimit; edhe pse mund të zgjidhet një rrugë e dytë ose e tretë, si ajo e kërkimit me titull ose autorë, por kjo mund ta vonojë procesin e kërkimit e në të njëjtën kohë procesin e përpunimit të librit. Lehtësi për shënim të vëllimit në fushën e ISBN-së do të krijonte përdorimi i nënfushës / c / menjëherë pas nënfushës / a /, ku

kjo e fundit është nënfusha e caktuar për numër të ISBN-së, ndërsa nënfusha / c / i pranon vërejtjet me shkrim.

Fushë tjetër specifike që kërkon më shumë sesa që ne i kemi afuar të dhëna është fusha e titullit, ose siç e njohin kataloguesit fusha / 100 /, e cila kërkon shënimin e emrit të autorit në original, duke filluar nga mbiemri e pastaj emri. Në këtë kontekst po flasim për funksionim e Listës autoriale. Lista autoriale e emrave i renditë të gjitha format e ndryshme të një autori / krijuesi nën një emër kryesor, që i lehtëson përdoruesit të nxjerrë lehtë njësi bibliografike të këtij autori. Ta zëmë, nëse kërkojmë në OPAC me emrin e një autori, ndërsa nuk ekziston lista autoriale për këtë emër, ne do të marrim rezultate vetëm për njësinë bibliografike që e mban këtë emër.

Pra, kjo është hapësirë që mundëson futjen e të dhënave të shumta sa i përket autorit, jo vetëm emrin, por, ta zëmë, edhe datën e lindjes ose të vdekjes, në rast se autori është i vdekur, pastaj është njëra ndër nënfushat, si nënfusha / c /, e cila në rastet kur autori përdor pseudonim ose antonim etj., e që do të ishte e rëndësishme që këta emra të dytë ose të tretë, me të cilët njihet, të specifikohen në të gjitha rastet, shembull *Mitrush Kutelin*, emri i parë i të cilit, ose emri me të cilin njihet që e ka bartur para se të shfaqej si autor në letërsi është *Dhimiter Pasko*, por që shumicën e teksteve (veprave) i ka vetshënuar me emra të tjerë si *Mitrush Kuteli* ose edhe *Izedin Jashar Kutrulija*, në këtë rast lexuesit të cilët mund ta njohin me vetëm njërin prej këtyre emrave do ta kenë të vështirë ose edhe të pamundur ta gjejnë veprën e tij në bibliotekë në rast se nuk kërkohet me emrin e saktë me

të cilin autori e ka nënshkruar tekstin e tij, pra do të ishte e rrugës që me mjetet e kërkimit nga ueb-faqe ose nga enciklopeditë e ndryshme te vendosen emrat e tjerë për arsye saktësimi dhe moslënije hapësirë për ndonjë mosverifikim (mosgjetje) të mundshëm. Dhe, nga shembulli që morëm shihet se ekzistuan disa mënyra të shkrimit të emrit të Mitrush Kutelit (këtu po i referohemi emrit i cili duket se njihet më së shumti nga lexuesit) dhe në të njëjtën kohë do të duhej që këta tre emra të vendosen në vendin përkatës.

Problem tjetër që mund të shfaqet gjatë procesit të përpunimit në katalog e që lidhet sërish me emrin e autorit është njëra nga nënfushat e titullit (fusha / 245 /, nënfusha / c / e cila e obligon plotësimin me emrin dhe mbiemrin e autorit, por ngecja këtu mund të dalë në rastet e autorëve të huaj të cilët te ne lexohen ndryshe nga ajo se si shkruhen shembull të shohim autorin francez Roland Bart, i cili me këtë emër ose edhe me emrin Rolan Bart, njihet te lexuesit shqiptarë, por që në origjinal shkruhet Roland Barthes, atëherë shkrimi i emrit në origjinal që është i obliguar në fushën / 100 /, i lejon kataloguesit që për shënim të emrit të autorit, në mënyrën se si lexohet, të shënohet te nënfusha / c / e fushës / 245 /. Kjo mënyrë e përshkrimit te ne është përdorur shumë pak. Po japim edhe një shembull tjetër atë të autorit Friedrich Nietzsche, i cili me gjithë prezencën me disa tituj të veprave në bibliotekë, është e pamundur, që nëse e kërkon me Fridrih Niçe (mënyrë kjo që edhe është më e lehtë por edhe është e përdorshme për lexuesin shqiptar, pasi që emri në origjinal është edhe paksa i vështirë për t'u germëzuar) të shfaqen të gjitha veprat e tij, ose është një funksion të cilin programi e kryen vetvetiu që të njëjtin autor, në rast të kërkimit me emër, shfaqen te hapësira e kërkimit të gjitha veprat e atij autori, që janë tashmë pjesë e fondit të bibliotekës. Me rastin e Niçes ndodh

e kundërta, d.m.th kërkimin rezultoi varësisht se si e kemi shënuar emrin e tij (është e pamundur që veprat e tij të shfaqen të gjitha përnjëherë në rastin e kërkimit të tyre bazuar në autorin - pra Niçen), që i bie sikur Niçe të ketë më shumë se një emër në origjinal dhe të ketë shumë mënyra leximi të emrit të tij në gjuhën shqipe. Dhe, rasti i kërkimit si në shembullin me NIÇE-n, mund të rezultojë me një ose më së shumti me dy tituj, pra jo shfaqja e të gjitha librave të tij që janë në fond brenda një hapësire të kërkimit. Do të krijohej lehtësi për përdoruesin, në rastet e kërkimit për autorë të huaj, të shënohen në mënyrën se si lexohen, për arsye të kërkimit dhe të gjetjes gjithësesi. Ose, kjo në rast se nuk do të praktikohet në këtë mënyrë, atëherë të paktën kjo do të kërkonte një punëtor referal, që do t'i njihete saktësisht mënyrën e shkrimit në origjinal të këtyre emrave për ta udhëzuar lexuesin që të arrijë deri te libri i autorit të kërkuar, në rast të kundërt ky libër/autor për një pjesë të madhe lexuesish do të rezultonte si libër (autor) i humbur, duke nënkuptuar këtu që edhe titulli i librit në gjuhë të huaj i po të njëjtit autorë do të rrezikonte njohjen e saktë të tij e gjithashtu edhe gjetjen në katalog.

Problem i dytë sa i përket shënimit të emrit evidentohet edhe rasti me autorët kur kanë dy e më shumë mbiemra, pra në rastet e autorëve të huaj e sidomos atyre spanjoll, portugez, latinoamerikan etj., ose edhe për autoret gra te martuara, të cilat bartin nga dy mbiemra. Shembull Nermin Vlora Falaschi në katalog mund ta shohim të shënuar edhe si Falaschi Vlora, Nermin ose Falaschi, Nermin Vlora, shembuj të tillë ka më shumë se një. "*Përshkrimi bibliografik i materialeve bibliotekare*", i botuar në Tiranë, në vitin 2001, e shpjegon me saktësi mënyrën e shënimit të mbiemrave të autoreve gra të martuara, duke nënvizuar se: *Emrat e përbërë të autoreve gra të martuara, mbiemri i të cilave përbëhet nga mbiemri para*

martese dhe mbiemri i burrit, përshkruhen me pjesën e parë të mbiemrit kur janë në gjuhën çeke, franceze, italiane, hungareze, spanjolle. Në të gjitha rastet e tjera përshkruhen sipas mbiemrit të burrit.

Këtu duhet të sqarohet edhe një tjetër element që është jo pak i rëndësishëm, ai i mbiemrave me vizë lidhëse, ku viza lidhëse përjashton rregullin e lartpërmendur, dhe obligon përshkrimin bibliografik, duke filluar nga pjesa e parë e mbiemrit e duke vazhduar me një vize lidhëse në mes dhe pastaj pjesa e dytë e mbiemrit.

Ngjashëm me saktësimin në leximin e emrit të autorit duhet të vepohet me variantet e titujve, në rastet kur libri është i shënuar me tituj të ndryshëm nga ai kopertinës me atë të faqes titullare, fusha / 245 / është fusha në të cilin shënohet titulli sipas shënimeve që dalin nga faqja e ashtuquajtur me gjuhën e bibliotekarisë - faqja titullare, por është e hapur për përdorim edhe fusha tjetër, fusha / 246 / për variantet e titujve që mund të jenë rezultat i një ndryshimi të titullit në kopertinë, fushë e cila përdoret shumë pak, por që do të ishte shumë praktike për një përdorim më të shpeshtë për faktin se lexuesi do të orientohej më lehtë në rrugën e gjetjes së librit.

Janë këto vetëm disa nga devijimet që vërehen gjatë përshkrimit të njësive bibliografike në katalogun elektronik, përkatësisht në formatin MARC, për të cilat do të duhej ngritur nivelin e përgjegjësisë. Dhe, një analizim i procesit të përshkrimit të njësive bibliografike nëpër këto fusha për të cilat folëm, përkatësisht i devijimeve që po paraqiten gjatë katalogimit, nuk e mohon faktin e ekzistimit të problemeve dhe shmangieve dhe në fushat e tjera - gjatë përshkrimit të njësive bibliografike. Kësaj here analizuar problemin e disa prej fushave, të cilat konsiderojmë të jenë më te ndjeshme jo vetëm për kataloguesin por edhe për përdoruesin, kur dihet se kërkimet më të shpeshta bëhen nëpërmjet kërkimit me autorë ose me titull.

ALEPH-i DHE PROCESI I PASURIMIT TË KOLEKSIONEVE NË BKUK



LAVDIE RRAHMANI

HYRJE

Me zhvillimin e teknologjive të reja informative, praktikat bibliotekare janë modifikuar në mënyrë radikale: dita - ditës po shtohet numri i bibliotekave të cilat po i bashkëngjiten fushatës për automatizimin e punës së tyre. BKUK është në mesin e bibliotekave që kanë ndërmarrë hapa për kalimin nga metodat tradicionale të kryerjes së punëve në bibliotekë në metoda shumë të avancuara, duke u mbështetur në zhvillimet më të fundit teknologjike, siç është sistemi i integruar bibliotekar Aleph 500.

MODULI I PASURIMIT - PËRDORIMI NË BKUK

Moduli i pasurimit është i dyti modul me radhë që ka filluar së funksionari në BKUK, (i pari është *Moduli i katalogimit*). Mundësitë dhe aspektet e Aleph-it respektivisht *modulit të pasurimit* në Aleph janë të shumta. Futja në funksion e këtij moduli në bibliotekën tonë nuk ka qenë e lehtë për faktin se është dashur të bëhen

rikonfigurime të shumta të modulit në mënyrë që ta përshtatim atë me mënyrën e funksionimit të Departamentit të Pasurimit në BKUK. Për javë të tëra ka punuar një ekip bibliotekarësh derisa në fillim të vitit 2007 është arritur të futet në përdorim.

Implementimi i *modulit të pasurimit* në BKUK ka bërë që sistemi tradicional i pasurimit të koleksioneve në bibliotekë të pësojë ndryshime. Këto ndryshime vërehen në të gjitha hallkat e këtij sistemi, duke filluar nga procesi i përgatitjes së porosisë, si informacion i brendshëm për pasurimin e koleksioneve, përgatitja e bazës së të dhënave për botuesit, shitësit dhe donatorët, verifikimi i njësive bibliografike dhe atyre fizike, përpunimi i thjeshtë i njësive bibliografike, vënia

e numrit rendor sipas renditjes në raft apo numri i signaturës, siç e quajmë ne brenda, si dhe RFID sistemi (Sistemi i Sigurisë së materialit bibliotekar).

Përmes Aleph-it, Departamenti i Pasurimit të Koleksioneve Bibliotekare që nga fillimi i vitit 2007, kur moduli i pasurimit është aktivizuar zyrtarisht, ka futur në bazën e të dhënave të botuesve rreth 272 adresa dhe emra botuesish përfshirë këtu edhe emrat e autorëve botues, si dhe disa donatorë që kanë dhuruar tituj me shumicë për BKUK-në. Këto të dhëna janë informacion i rëndësishëm, si për kontrollin që Departamenti i Pasurimit është i obliguar t'i bëjë Ekzemplarit të Detyrueshëm, ashtu edhe për nxjerrjen e statistikave rreth pasurimit të koleksioneve.

Moduli i Pasurimit

- Në Modulin e Pasurimit, mund të zgjedhni një nga gjashtë
- tastet:

- Tasti i porosisë
- Tasti i faturimit
- Tasti administrativ
- Tasti i indeksëve
- Tasti i serialeve
- Tasti i kërkimit

Acquisition Training (v.17.01)


Departamenti i pasurimit në BKUK është i obliguar të mbledhë të gjitha materialet në të gjitha formatet në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera që botohen në vazhdimësi në Kosovë, botimet e vjetra të rëndësishme për Kosovën dhe shqiptarët (dorëshkrime, libra, periodik i vjetër), materiale në gjuhë të ndryshme të botës që flasin për Kosovën dhe për shqiptarët, etj.

Natyrisht se ndër proceset më të rëndësishme është selektimi i materialit për blerje, si dhe atij për përpunim nga dhuratat e shumta që vijnë në BKUK në mënyrë të vazhdueshme.

Materiali i selektuar për përpunim kërkon verifikim të hollësishtëm nëse në koleksionet e bibliotekës ekziston ndonjëri prej titujve dhe sa njësi fizike ekzistojnë në fond. Ky verifikim bëhet me lehtësi dhe shumë shpejt përmes *Modulit të pasurimit* në Aleph, gjë që në të kaluarën ky proces, pra verifikimi i titujve në inventarët tradicionalë ose në skedarët manualë, bibliotekarit i ka marrë më shumë kohë dhe mund. Procesi i verifikimit bëhet për arsye sigurie që njësitë bibliografike që tashmë ekzistojnë në katalogun elektronik të mos duplikohen si dhe numri i njësive fizike në fond të mos e kalojë numrin e përcaktuar me rregullat e pasurimit të koleksioneve. Moduli i pasurimit, përveç menysë kryesore të kërkimit, të cilën e kanë edhe modulet e tjera, ka edhe menynë e kërkimit përmes porosisë. Kjo mënyrë kërkimi ka rolin e nxjerrjes së informatave lidhur me metodën e pasurimit, numrin e kopjeve, botuesin, datën e përpunimit të materialit, lokacionin e vendosjes së kopjeve etj.

Pas procesit të verifikimit, bibliotekari bën:

një përshkrim të thjeshtë bibliografik



të titullit përmes modulit të pasurimit. Ky është një proces që ne e quajmë parakatalogim (përshkrim elementar i informacionit të njësisë bibliografike) - prej nga në një fazë tjetër të përpunimit njësia i nënshtrohet katalogimit të plotë;

me këto shënime bibliografike krijohet rekordi bibliografik e pastaj krijohet porosia për titullin e caktuar;

në mënyrë automatike sistemi krijon aq njësi sa kopje kemi porositur; procesin e katalogimit e vazhdojnë bibliotekarët katalogues deri në fazën kur njësia bibliografike konsiderohet e përfunduar;

ky material më tutje i nënshtrohet sistemit të vendosjes së numrit rendor sipas të cilit bëhet renditja e materialit në raftet ose numrit të signaturës;

dhe krejt në fund materiali i nënshtrohet sistemit të RFID-së (sistemi i sigurisë së materialit bibliotekar)

Moduli i pasurimit dhe ai i katalogimit janë të ndërlidhur në mes vete ashtu që të gjitha të dhënat

që futen në *modulin e pasurimit* mund të shfaqen në modulin e katalogimit dhe anasjelltas.

MUNDËSITË E ZGJERIMIT TË PËRDORIMIT TË MODULIT TË PASURIMIT

BKUK është në fazën e daljes prej sistemit të vullnetarizmit e donacioneve dhe fillimit të funksionimit të sistemit të blerjes së materialit bibliotekar (sidomos periodikut shkencor dhe profesional) përmes parapagimit. Alephi ofron mundësi të mira për realizimin e këtij procesi dhe ne mendojmë së shpejti të startojmë me këtë mënyrë të pasurimit të koleksioneve.

Moduli i pasurimit në Aleph ofron edhe shumë mundësi të tjera, të cilat aktualisht ne nuk i shfrytëzojmë; p.sh. mundësia e kontrollimit të parave që shpenzohen për blerjen e materialeve bibliotekare, mundësia e lidhjes së sistemit të brendshëm të porosisë së materialit me sistemin financiar të botuesve dhe shitësve të ndryshëm edhe jashtë Kosovës etj.

FATI I GAZETAVE E I GAZETARËVE

BERAT DAKAJ

Konica qe një aventurier i kërkimit të dijes enciklopedike, njëkohësisht aventurier në lidhje dashurie; aventura nuk i mungoi as në diplomaci. Një aventurizëm, përmes të gjitha këtyre shtigjeve, e kaloi edhe në formimin e gazetave e të revistave. I lëkundshëm qe edhe atëherë kur e donte e, e urrente Zogun. Aventura e paradokse i ndodhën edhe skeletit të tij! Më 1942-n la një testament që t'ia lëshonin, kurdoherë, eshtrat në dheun e atdheut, por ata morën biletën e udhëtimit për në Shqipëri vetëm pas 53 vjetësh. Çfarë urrejtje ndaj një grushti eshtrash! Megjithëqë, faleminderit prej testamentit të vdekjes dhe të gjithë atyre që e kuptuan që, pas të gjitha këtyre ecjakeve anekënd botës të Konicës, e kthyen skeletin e tij në Tiranë, aty pranë varreve të vëllezërve Frashëri.

Historia e gazetarisë shqiptare është, fatkeqësisht, shumë e mjerueshme materialisht. Kujtojmë periudhën e parë të gazetarisë moderne, *Albaninë* e Konicës, *Dritën* e Shahin Kolonjës, *Kombin* e Sotir Pecit. Njëkohësisht, kur kujtohen këta botues, është e pashmangshme të mos kujtohet edhe historia e veprimtarisë së gazetave të tyre.

Albania e Konicës doli më 25 mars 1897 në Bruksel, e jetëgjatësi botimi pati deri në shkurt të 1909-s. Në të 12 vjetët e saj ajo trajtoi tema nga letërsia, gjuha, folklori, diplomacia etj. Kjo larushi tematike si dhe shkrimi, gjuha, dizajni, faqet e saj etj., bënë që historianët e gazetarisë,

pas nja pesëdhjetë vjetësh të shuarjes së *Albanisë* e të Konicës, në të ta shohin fillimin e gazetarisë moderne shqiptare, njëkohësisht edhe Konicën një gazetar modern dhe brilant.

Sipas disa të dhënave për jetën e Konicës, të ofruara të shkruara nga profesor doktor Jup Kastrati, në monografinë më të plotë shkruar për Konicën, është thënë se ai (Konica) që herët përpigëj të botonte një gazetë dhe pas një kohe të gjatë e pas përkrahjes nga disa dashamirë të kombit shqiptar, doli në shitje, më 25 mars 1897, numri i parë i *Albanisë*. Konica në këtë kohë ishte vetëm 21 vjeç! Më tutje...

Për ta nxjerrë numrin tjetër të *Albanisë*, Konica iu drejtua "peshqve" më të mëdhenj. Është thënë se më 25 nëntor 1897 pati takim me ministrin e Jashtëm të Perandorisë Austro-Hungareze, Baron Gulovchskin, i cili urdhëroi Ambasadën Austro-Hungareze në Bruksel që t'i heqë shpenzimet e tipografisë së revistës.

Albania deri në vitin 1902 botohej herë pas here, mirëpo pas zhvendosjes së Konicës dhe revistës në Londër në këtë vit, ajo botohej si e përmuajshme e rregullt. Në fillim botohej 12 faqe, dikur 32, 48, rrallëherë 64, krejt kjo sipas mundësive financiare të Trank Spiro Beg (pseudonim i Faik Konicës). Gjuhë e shkrimeve të saj ishte shqipja, frëngjishtja e turqishtja (pra botohej në këto tri gjuhë). Ndërsa qëllim të të gjitha shkrimeve në këto gjuhë kishte: *MBRON TË DREJTAT E KOMBIT SHQIPË-TAR*, e, një motiv më gjithëpërfshirës pati këtë: *Qëllimi i gazetës është të mbahet e të rritet kombësia. Të lërohet e të zbukurohet gjuha, se gjuha është shënimi i kombësisë. Të përmirësohet*



Faik Konica

gjindja e popullit, se, kur s'është i vobekët populli kombësia mbetet e tërë, e fortë, e lirë. Vjersha. Këngë të popullit. Gjuhësi. Histori. Shkencë. Të ra. Albania e madhe më 1899 lindi edhe një *Albani të vogël*, një nënshtojcë e cila u botua në 12 vëllime, deri më 1903. Por, fati i letrave është si i njeriut. Revista *Albania* rrezikohet dita-ditës ekonomikisht, e botuesi i saj, Konica, plakej ngadalë, bredhte rrugëve të botës e të konsulatave për të kërkuar ndonjë grosh për botimin e revistës, pasi që, për fitim nga gazeta, as që bëhej fjalë. Kështu që, i shtyrë nga këto rrethana e "sulme" që i bëheshin atij e revistës, në një ditë me diell të 1909-s lindi gazeta *Dielli*, organ i Federatës Panshqiptare Vatra, por u shua *Albania* po më 1909, pasi që Konicës i kërkohet të shkonte në Amerikë ta udhëhiqte *Diellin*, dhe ashtu veproj.

Konica nuk ishte Lazër Gush. Nëse Lasgush poeti pranonte se më i rëndësishëm ishte një varg sesa një studim, për Konicën qe e kundërta. Ai ndoqi ligjërata rreth e qark botës. Kur diplomoi Konica, në

Universitetin e Harvardit në Nju-Jork, ishte 50-vjeçar, por atëkohë ishte poliglot, fliste më shumë se 16 gjuhë të mëdha, madje kishte miqësi me njerëzit më në zë të botës. Por, në natën e acartë të 14 dhjetorit 1942, Konica ndërroi jetë në Uashington. Pak para se të vdiste ua kishte lënë një testament Nolit dhe Lame Kodrës (Sejfullah Malëshovës), për të cilët qe i bindur se e kishin kuptuar më së miri, e nga të cilët kërkonte që, pas vdekjes, t'ia kthenin ata grusht eshtrash në Shqipëri. Ata të dy donin ta kryenin amanetin, por rrethanat politike të krijuara në atë kohë nuk i lejuan të vepronin. Aq më keq që, as Enver Hoxhaj nuk lejonte që eshtrat e Konicës të futeshin në dheun e Shqipërisë, së paku, jo për të gjallë të tij. Tek pas 53 vjetësh, më 1995, eshtrat e tij, të futur në arkivol, në një aeroplan, përskej një arkivoli tjetër, në të cilin gjendeshin eshtrat e Bilall Xhaferrit, zbritën e u varrosën në parkun e Tiranës.

"Albania" e tij sot pushon nëpër biblioteka të ndryshme të botës, edhe në Kosovë e Shqipëri, kurse idetë e Konicës qarkullojnë edhe sot e tutje në ndeja e letra (libra, analiza, kumtesa), janë të pavdekshme, edhe atëherë kur, ata që nuk kanë çfarë të thonë, duhet ta kujtojnë Zotin:

"Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë të mbajmë gojën mbyllur kur shkemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëziona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por dhe të sillemi ashtu. Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthimet e shtypit. Ashtu qoftë!"

Pas *Albanisë*, jehonë të madhe në shtypin e gazetarisë shqiptare bëri edhe *Drita* e Shahin Kolonjës, e cila u botua 8 vjet, nga 1 nëntori i 1901- s deri më 1909, në Sofje të

Bullgarisë, në shtypshkronjën *Mrothësia* të Kristo Luarasit. Në këtë vit Kolonja e mbaroi misionin e botuesit, po e filloi atë të politikanit, meqenëse, pas një kohe, doli i zhgënjyer.

Dihet që Kolonja, ashtu sikurse Konica, menjëherë pas studimeve, të cilat i mbaroi për juridik, përpiquej të botonte një gazetë. Kishte pasur një takim edhe me Ismail Qemalin për themelimin të gazetës, por nuk ishin marrë vesh, pasi që ai kërkonte gazetë pro xhonturqve, Kolonja kundër tyre. E, ashtu si *Albania* e Konicës, edhe *Dritës* së Kolonjës në ballinë i shndriste një epigram: *Mpron të drejtat e kombit shqiptar*, kurse moto kishte *Punoni për vehten tuaj* (në të majtë), *Mos për botë e për të huaj* (në të djathtë). Në *Dritë* botoheshin, ndoshta për të parën herë në atë kohë, lajme për kryengritjet shqiptare, si ajo e vitit 1908, për të cilat lajme Noli e vlerësoi *Dritën*: "Gazetën më popullore në Shqipëri". Gjendja e dobët financiare e *Albanisë* e përcolli edhe *Dritën*. Kolonja, dikur, kur i rrezikohej jeta e *Dritës* dhe e vetja, pra kur s'i kishte paratë as për të blerë një bukë e shtypur asnjë faqe, i shkruante një mikut shumë të ngushtë, Hamdi Ohrit, për, gati, shuarjen e *Dritës* dhe vetes: *Për të nxjerrë numrin e ri, nesër do të shkoj të shes sahatin. Pastaj edhe më tutje më ndihmoftë Zoti [...]*. E ashtu si Konica, fitim nga gazeta nuk priste as Kolonja: *Ka shumë kohë i dashur Hamdi që unë vuaj nga një mijë provacione... dhe sa keq jetoj unë... një grosh për drekë dhe një grosh për darkë...tani që po të shkruaj unë nuk kam asgjë për të ngrënë. Gjumi po më ikën dhe shpeshherë dëshpërohem. Megjithatë shpresa ime bëhet më e madhe, jo më e vogël dhe për sa kohë që unë jetoj nuk kam për të hequr dorë...* Dhe kështu ngadalë fikej *Drita* e

Kolonjës, por në Amerikë ndriçonte *Kombi* i Sotir Pecit.

Gazeta *Kombi* u botua në Boston më 6 qershor 1906, në katër gjuhë: shqip, anglisht, frëngjisht e italisht. Ndërsa u shua pas tre vjetësh. Ashtu si *Dritës*, e cila kishte rreth 500 abonentë, por prej tyre vetëm 46 paguanin abonimin, të tjerët i mbetnin borxh e nuk i paguanin kurrë, po njëjtë i ndodhte edhe *Kombit*. Madje, po sikur *Albania* e *Drita*, edhe *Kombi* kishte qëllim... *përparimin e çështjes politike dhe lëvrimin e gjuhës së vet, t'u japë emër dhe ndihmë gjithë atdhetarëve që përpiquej për këto qëllime, t'u hapë sytë duke u dëftuar udhën e drejtë dhe rreziqet e kombit prej intrigave të armiqve; shqiptarëve që nuk interesohen, t'u fusë nxehtësinë e shenjtë, e cila quhet atdhetarizëm; me pak fjalë të jetë mbrojtëse, ndihmëse, këshilltare dhe luftëtare e interesave të kombit.*

Kombi kishte fuqi të madhe ndikim politik, letrar e gjuhësor, por jo fuqi jetëgjatësie. Ata që e lexonin (abonentët) nuk e paguanin, prandaj detyrimisht ishte i gatshëm të shuhej.

...Tashti gazeta gjendet në rrezik, tashti në vend të përparimit, në vend të shtimit, KOMBI do të vdesë nga uria. Famën, nderin, shpresat dhe shërbimin që i bën atdheut me të shtypurit e tij do t'i zëvendësojë turpi, çndërimi, dëshpërimi dhe dëmi. Armiqtë tanë do t'ju bijen trumpetave në të katër anët se shqiptarët nuk janë të zotët për asgjë, nuk janë të arrirë për vetqeverim dhe liri, s'punojnë me rëndësi, nuk kanë ndjenja atdhetare, se 30 mijë syresh nuk ishin të zotët të mbanin një gazetë.

Kombi u shua më 1909. Nuk u përpoq më askush ta ringjallë. Peci ikën për në Amerikë në moshën 51-vjeçare, por aty vdes pas pesë vjetësh.

DITA BOTËRORE E LIBRIT NË BKUK

Prishtinë, 23 prill 2008

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, ka organizuar një manifestim, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Librit dhe e të Drejtës së Autorit. Me rastin e kësaj dite, të caktuar nga UNESCO, si ditë ndërkombëtare që festohet për të promovuar leximin, botimin, si dhe mbrojtjen e pronës intelektuale nëpërmjet të drejtës autoriale, ishin të ftuar nxënës, studentë, shkrimtarë, botues dhe përfaqësues të institucioneve të Kosovës.

Manifestimi është përshëndetur nga drejtori i BKUK-së dhe përfaqësues të rëndësishëm të kulturës dhe të institucioneve, si dhe janë dhuruar simbolikisht 99 libra për lexuesit e moshave dhe profileve të ndryshme.

Janë lexuar edhe fragmente të veprave të shkrimtarëve të njohur botëror Servantesit dhe Shekspirin, si dhe, për nder të 100-Vjetorit të lindjes së gjuhëtarit të madh Eqrem Çabej, është emetuar zëri i tij, i incizuar gjatë ligjëratave të tij të mbajtur me studentët e Universitetit të Prishtinës.



Dita Ndërkombëtare e Librit dhe e të Drejtës së Autorit në BKUK

Në Ditën Ndërkombëtare të Librit dhe e të Drejtës së Autorit, BKUK dhe botuesit kosovarë promovuan projektin i cili parasheh që në përvjetorët e kësaj dite të themelojnë nga një bibliotekë të re me fondin e librave që do të dhurojnë autorët, botuesit, institucionet dhe individët. Kjo iniciative filloi me dhurimin e një fondi librash për themelimin e bibliotekës së shkollës në fshatin Guncat të Malishevës.

KREU I KOMUNËS SË PRIZRENIT NË PËRKRAHJE TË BIBLIOTEKAVE

Prishtinë, 24 korrik 2008

Kreu i Komunës së Prizrenit - Ramadan Muja, ka prituri drejtorin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, Sali Bashota si dhe drejtoreshën e Bibliotekës Ndërkomunale të Prizrenit, Sahadete Sadikaj.

Në këtë takim, kreu i komunës së Prizrenit ka premtuar përkrahje për të ndihmuar procesin e automatizimit të Bibliotekës Ndërkomunale të Prizrenit, si dhe të të gjitha bibliotekave komunale dhe bibliotekave të institucioneve shkollë e universitare, duke premtuar, njëkohësisht edhe përkrahje në infrastrukturë dhe pasurim të fondeve të bibliotekave.

Biblioteka Ndërkomunale e Prizrenit është biblioteka e parë e pajisur në programin "Aleph 500", e cila synon ta zhvillojë dhe zgjerojë këtë program edhe në bibliotekat e tjera në kuadër të komunës së Prizrenit, me qëllim që të lehtësojë punën e kësaj bibliotekë në ofrimin e shërbimeve.

INAUGUROHET BIBLIOTEKA SHKOLLORE NË GUNCAT TË MALISHEVËS

Malishevë (Guncat), 13 maj 2008

Në kuadër të projektit të iniciuar nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, që, çdo vit, simbolikisht, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Librit dhe e të Drejtës së Autorit, të themelohet nga një bibliotekë në njërin nga shkollat e Kosovës, sot është inauguruar biblioteka e parë në shkollën fillore "Dëshmorët e Kombit" në Guncat të Malishevës.

Në kuadër të këtij projekti, bibliotekës së shkollës së Guncatit i janë dhuruar 503 tituj, përkatësisht 1100 ekzemplarë - literaturë për fëmijë dhe të rritur, nga botues, institucione dhe individë, si: Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Shtëpia Botuese „Faik Konica”, Shtëpia Botuese „Artini”, Shtëpia Botuese „Rozafa”, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, PEN Qendra e Kosovës, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shtëpia Botuese, "Libri Shkollor", si dhe nga shkrimtari dhe studiuesi - dr. Milazim Krasniqi.

BKUK - NË SIMPOZIUMIN E BIBLIOTEKAVE TË SHTETEVE TË BALLKANIT

Turqi (Edirne), 5-7 qershor 2008

Në Edirne të Turqisë, nga 5-7 qershor 2008, u mbajt simpoziumi "Menaxhimi i informacioneve/dokumenteve, dhe bashkëpunimi midis bibliotekave në vendet e Ballkanit". Në këtë simpoziium morën pjesë: Turqia, Kosova, Bullgaria, Kroacia, Rumania, Serbia, Moldavia, Bosnja e Hercegovina dhe Greqia.

Simpoziumi trajtoi tema nga fusha e bibliotekarisë dhe mënyrën se si bibliotekat të luajnë rol më të fuqishëm në marrjen e iniciativave të bashkëpunimit të vendeve të Ballkanit në këtë fushë. Në këtë aktivitet, Kosova u përfaqësua nga drejtori i BKUK-së, dr. Sali Bashota, dhe nga Besim Kokollari, udhëheqës i programit "ExLibris Aleph500".

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të Kosovës në këtë simpoziium me karakter ballkanik u mbështet nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), misioni në Kosovë.

Në këtë simpoziium, Kosova ishte në qendër të diskutimit, sidomos në paraqitjen e panelit plenar të prof.



Dr. Sali Bashota (Kosovë), Hüseyin Baci (Turqi) dhe Besim Kokollari (Kosovë)

Stoyan Denchev, nënpresident i Konferencës së Rektorëve të Republikës së Bullgarisë, dhe të prof. dr. Huseyin Baci, nga Universiteti Teknik i Lindjes së Mesme në Ankara të Turqisë.

FESTOHET DITA E PAVARËSISË SË SHBA-ve

Prishtinë, 4 korrik 2008

Është festuar me një simbolikë të veçantë, Dita e Pavarësisë së SHBA-ve në Këndin Amerikan të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, nëpërmjet fjalëve përshëndetëse, mirënjohjeve, muzikës, lojërave shpërblyese, kuizeve.

Laura Hotchla, zëvendëssehefe për Marrëdhënie me Publikun, në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, ka falënderuar në emër të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara amerikane, duke thënë se është një nder që këtu në Kosovë festohet aq shumë pavarësia e Amerikës. Laura Hotchla e ka cilësuar me fat faktin që në Kosovë janë tri kënde të tilla: në Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicën Veriore. Ajo, ndër të tjerash, ka theksuar se Këndi Amerikan në Prishtinë është shumë fatlum që ka vullnetar aq të shumtë dhe fal tyre është bërë edhe realizimi i shënimit të kësaj date.

Aktivitetet festive, me rastin e 4 Korrikut, i ka hapur koordinatorja e Këndit Amerikan në Prishtinë, Arta Buzhala, ndërsa në emër të Këndit Amerikan në Prishtinë, vullnetarët e këtij Këndi, në shenjë falënderimi për mbështetje, i kanë ndarë mirënjohje Ambasadës Amerikane në Prishtinë.



Dita e Pavarësisë së SHBA-ve në Këndin Amerikan

BKUK - NË KONGRESIN BOTËROR TË IFLA-S

Kanada (Quebec), 15 gusht 2008

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës u përfaqësua në mesin e institucioneve më të larta bibliotekare të shteteve të ndryshme të botës, në Kongresin e 74-të Botëror të IFLA-s në Quebec të Kanadasë.

Federata Ndërkombëtare e Shoqatave dhe Institucioneve Bibliotekare (IFLA), nga data 10 deri 15 gusht 2008, mbajti Kongresin e 74-të me radhë në qytetin Quebec të Kanadasë, në të cilin morën pjesë përfaqësues të institucioneve më të ndryshme nga mbarë bota. Tema bosht e këtij Kongresi ishte: "Bibliotekat pa kufij: drejt mirëkuptimit global".

Kongresi kishte sesione të ndryshme, si ato në zhvillimin e bibliotekave kombëtare, publike, speciale, trajnim e zhvillim, bashkëpunim bibliotekar etj.; seminare, takime e diskutime me karakter të veçantë bibliotekar e informativ, panair të botuesve të mëdhenj botëror në fushën e bibliotekarisë, ekspozita të kom-

panive që ofrojnë pajisje audio-vizuale, sisteme kompjuterike, shërbime informative, shërbime të avancuara digjitale etj.

Në këtë Kongres, nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës (BKUK) morën pjesë Drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, dr. Sali Bashota, dhe Kryetari i Shoqatës së Bibliotekarëve të Kosovës, Besim Kokollari. Qëllimi kryesor i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të BKUK-së në këtë Kongres ishte paraqitja e kërkesës me shkrim Bordit udhëheqës të IFLA-s për pranimin e BKUK-së dhe të Shoqatës së Bibliotekarëve të Kosovës anëtarë të rregullt të kësaj Federate botërore të bibliotekave, duke e përfaqësuar republikën e Kosovës me kodin e saj shtetëror.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të Republikës së Kosovës në këtë Kongres bibliotekar me karakter botëror është mbështetur financiarisht nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) Misioni në Kosovë.

BKUK-së I SHTOHEN EDHE DY BURIME ELEKTRONIKE NGA FUSHA E MUZIKËS

Prishtinë, 11 shtator 2008

Du burime të veçanta elektronike iu shtuan koleksioneve elektronike të Sektorit të Muzikës në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës: Grove Music Online dhe Encyclopedia of Popular Music. Të dy këto burime u dedikohen në radhë të parë lexuesve e përdoruesve të profilit muzikor, e më pas edhe përdoruesve të interesuar të profileve të tjera.

Grove Music Online është burim elektronik më autoritativ në të gjitha aspektet në fushën e muzikës. Ky burim përfshinë 50 000 artikuj dhe 28 000 biografi në të cilat kanë kontribuar mbi 6 000 studiues nga e mbarë bota. Abonimi në Grove Music Online përfshin edhe Oxford Companion to Music (2002), i cili ofron më shumë se 8 000 artikuj për kompozitorë, dirigjentë, interpretues, vepra individuale, instrumente, forma dhe zhanre muzikore.

The Oxford Dictionary of Music (2006), është burim

elektronik që jep informacione më të gjera në fushën e muzikës, duke i plotësuar nevojat kryesisht të studentëve në studimet themelore si dhe të përdoruesit të interesuar.

Encyclopedia of Popular Music - i botuar në 10 vëllime, tashmë ofrohet në formë elektronike përmes internetit edhe në BKUK. Ajo ka 27 000 zëra, të cilët mbulojnë tema nga muzika popullore e të gjitha zhanreve të periudhës prej vitit 1900 deri më sot. Jepen po ashtu edhe data të rëndësishme, biografi dhe informacione më të gjera për artistët të përfshirë në këtë enciklopedi së bashku me një diskografi të kompletuar që përfshinë etiketat e incizimeve, datën e botimit, si dhe një sistem të rangimit me 5 yje të albumeve të tyre.

Duhet të theksohet se abonimi në këto dy burime të Oxford University Press është mbështetur financiarisht nga Raiffeisen Bank në Kosovë me vlerë prej 4,782,76 dollarëve amerikanë për tri vite në vazhdim deri më 31 tetor 2011.

Oxford Music Online

SESION PËR MODERNIZIMIN DHE AUTOMATIZIMIN E BIBLIOTEKAVE TË KOSOVËS

Prishtinë, 4 shtator 2008

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, organizoi sesionin: "Sistemi i Integruar Aleph 500 në Bibliotekat e Kosovës", i cili kishte për qëllim njoftimin e bibliotekarëve, profesionistëve dhe vendimmarrësve për biblioteka lidhur me fazën e parë të modernizimit dhe automatizimit të bibliotekave publike të Kosovës.

Fjalën e hapjes e paraqiti drejtori i BKUK-së, dr. Sali Bashota, i cili dha një pasqyrë të pëgjithshme për implementimin e Programit Aleph 500 dhe rezultatet që ka arritur BKUK nëpërmjet këtij programi, duke përfshirë këtu edhe zgjerimin e këtij rrjeti në bibliotekat publike.

Drejtori Bashota ka përmendur se BKUK, e cila sipas Ligjit për Bibliotekat, është qendër e organizimit dhe menaxhimit të rrjetit bibliotekar në Kosovë, ka marrë përgjegjësi që të shtrijë rrjetin e programit bibliotekar Aleph 500 në bibliotekat ndërkomunale të Kosovës me licenca testuese dhe funksionale

Ai më tej ka theksuar se BKUK, duke u mbështetur në zhvillimin e këtij programi në bibliotekat e Kosovës, ka hartuar dy projekte paralele: njërin për automatizimin e shërbimeve bibliotekare në bibliotekat ndërkomunale të Kosovës dhe tjetrin për automatizimin e shërbimeve bibliotekare për bibliotekat e fakulteteve të Universitetit



Sesioni "Sistemi i Integruar Aleph 500 në Bibliotekat e Kosovës"

të Prishtinës dhe, si rrjedhojë, projektet u janë dorëzuar Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe udhëheqja e BKUK-së pret mbështetje financiare të këtyre projekteve për vitin 2009.

Programi Aleph 500, pos BKUK-së dhe bibliotekave ndërkomunale, parashihet të shtrihet edhe në të gjitha bibliotekat e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës, pastaj në Bibliotekën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bibliotekat e institucioneve më të larta shkencore e kulturore etj., në mënyrë që të krijohet katalogu përmblendës i materialeve bibliotekare në Kosovë që është një nga projektet më kapitale të bibliotekarisë, i cili u ofron lex-

uesve informacione të shpejta e të sakta për koleksionet bibliotekare në përgjithësi.

Drejtori i BKUK-së ka bërë thirrje për një përkrahje më të madhe të institucioneve qeveritare, në mënyrë që të shtrihet dhe zgjerohet rrjeti i këtij programi në tërë Kosovën.

Në këtë sesion kanë referuar: Besim Kokollari, i cili ka folur për Projektin Aleph në rrjetin e bibliotekave të Kosovës; Ramush Zeka - për administrimin harduerik dhe softuerik të SIB Aleph 500; Lavdije Rrahmani - për Aleph-in dhe procesin e pasurimit të koleksioneve në BKUK; si dhe Bukurije Haliti, e cila ka folur për katalogun dhe katalogimin respektivisht për perspektivat e zhvillimit të programit Aleph në Kosovë.

TAHIR FONIQI, TIPAT E BIBLIOTEKAVE NË KOSOVË: 1944-1986, BKUK, PRISHTINË 2008

Libri, "Tipat e bibliotekave në Kosovë: 1944-1986", është libri më i ri i përgatitur nga studiuesi Mr. Tahir Foniqi, i cili para lexuesit prezanton në formë përmbledhëse historikun e bibliotekave në Kosovë gjatë periudhës 1944 - 1986.


Libri përmban një numër shumë të madh shënimesh statistikore mbi numrin e bibliotekave, tipat e bibliotekave dhe numrin e fondeve. Në të janë trajtuar një numër i konsideruar temash, si: formimi i rrjetit të bibliotekave, struktura e koleksioneve që posedojnë bibliotekat, problemi i strukturës së përdoruesve të koleksioneve bibliotekare, mbi kuadrot profesionale dhe mënyrën e rregullimit të koleksioneve, veprimtarinë arsimore e kulturore të bibliotekave.

Libri "Tipat e bibliotekave në Kosovë: 1944-1986" është i pajisur edhe me shënime sqaruese dhe fusnota.

**SINAN GASHI, MOZAIKU ARTISTIK (1930 - 1939), [AUTORIJ], PRISHTINË 2008**

Shkrimtari dhe publicisti Sinan Gashi, paraqitet para publikut me botimin më të ri me titull "Mozaiku artistik (1930 - 1939)". Në këtë libër autori hedh dritë mbi kulturën, artet dhe letërsinë e viteve 30-ta të shekullit XX, që, sipas autorit, është periudha me e suksesshme në krijimtarinë letrare, ku u vunë bazamentet fillestare të disa gjinive e llojeve të artit; me aktorë më të përkushtuar, me letrarë idealistë e arsimtarë, me intelektualë ambiciozë e sakrifikues, muzikantë shumë të përkushtuar, piktorë jashtëzakonisht të talentuar.

Libri "Mozaiku artistik (1930 - 1939)", riaktualizon emrat e shumë krijuesve të anatemuar siç ishin: Gjergj Fishta, Asdreni, Kristo Floqi, Anton Harapi, Bernardin Palaj etj.. Ky botim, po ashtu, përmban edhe të dhëna të shumta bibliografike, ku përfshihet një listë e gjatë e titujve të librave dhe periodikut të botuar gjatë viteve 1930 - 1939.

**BIBLIOGRAFIA PËRMBAJTËSORE E SEMINARIT NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE 1974-2007, INSTITUTI ALB-SHKENCA, PRISHTINË 2008**

Puna dhe veprimtaria 25-vjeçare e Seminarit për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, është prezantuar kohëve të fundit para lexuesit në formë të përmbledhur bibliografike, nga studiuesi Dr. Begzad Baliu dhe botuar nga Instituti Alb-Shkenca. Në këtë bibliografi janë të radhitura, sipas standardeve bibliografike, të gjitha punimet, studimet, kumtesat, ligjëratat etj., të revistës së këtij institucioni me të njëjtin emër, e cila gjatë viteve 1974-2007 ka nxjerrë në dritë njëzetë e pesë numra në tridhjetë vëllime.

Bibliografia përmban një parathënie, në të cilën autori ofron të dhëna të çmueshme mbi historikun e themelimit dhe veprimtarisë 25-vjeçare të Seminarit për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare.

Bibliografia është e organizuar në dy forma: në radhitje kronologjike, sipas numrave të revistës, ku për brenda saj është e përdorur mënyra e radhitjes sipas pasqyrës së lëndës së revistës, duke vazhduar me pas sipas alfabetit; dhe në formën e dytë, respektivisht në radhitje alfabetike globale. Në çdo njësi bibliografike, autori ka ofruar edhe disa të dhëna përshkruese, si: nëntitujt e punimeve, shënimet dhe fusnotat. Bibliografia, gjithsej ka 1395 njësi bibliografike, të radhitura në 369 faqe.

Në kuadër të saj është punuar edhe një listë me emrat e pjesëmarrësve të huaj në Seminar gjatë viteve 1974-2007 dhe, krejt në fund, indeksi alfabetik i autorëve të ligjëratave dhe kumtesave.



Gjon BERISHA